



Rregullorja e UEFA-së për Licencimin e Klubeve për
Ligën e Kampionëve të UEFA-së për Femra

Botimi 2024

Përmbajtja	
Preambula	6
I – Dispozitat e përgjithshme	7
Neni 1 Sfera e aplikimit	7
Neni 2 Objektivat	7
Neni 3 Përgjegjësitë e Organit të UEFA-së të Kontrollit Financiar të Klubeve	8
Neni 4 Përkufizimi i termave	8
II – Licencimi i Klubeve të UEFA-së	14
Kapitulli 1 - Licencuesi	14
Neni 5 Përgjegjësitë e licencuesit	14
Neni 6 Administrimi i licencimit	14
Neni 7 Organet vendimmarrëse	15
Neni 8 Katalogu i sanksioneve	16
Neni 9 Certifikimi i licencuesit	16
Neni 10 Procesi kryesor	16
Neni 11 Procedurat e vlerësimit	17
Neni 12 Trajtimi i barabartë dhe konfidencialiteti	17
Neni 13 Politika e përjashtimeve	17
Kapitulli 2: Aplikuesi për licencë dhe licenca	17
Neni 14 Përkufizimi i aplikuesit për licencë dhe rregulli tre-vjeçar	17
Neni 15 Përgjegjësitë e përgjithshme të aplikuesit për licencë	18
Neni 16 Licenca	18
Neni 17 Leja e posaçme	19
Kapitulli 3: Kriteret e licencimit të klubeve	19
Neni 18 Të përgjithshme	19
Kriteret sportive	19
Neni 19 Programi për zhvillimin e të rinjve	19

Neni 20 Ekipet e të rinjve për femra	20
Neni 21 Kujdesi mjekësor i lojtareve	20
Neni 22 Regjistrimi i lojtareve	20
Neni 23 Kontrata me shkrim me lojtare profesioniste	21
Neni 24 Huazimi i lojtareve profesioniste	21
Neni 25 Çështjet e referimit dhe Ligjet e Lojës	21
Kriteret e përgjegjësisë sociale të futbollit	21
Neni 26 Strategjia e përgjegjësisë sociale të futbollit	21
Neni 27 Barazia dhe përfshirja	21
Neni 28 Anti-racizmi	21
Neni 29 Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve dhe të rinjve	21
Neni 30 Futbollit për të gjitha aftësitë	22
Neni 31 Mbrojtja e mjedisit	22
Kriteret e infrastrukturës	22
Neni 32 Stadiumi për Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra	22
Neni 33 Ambientet e stërvitjeve - Disponueshmëria	22
Neni 34 Ambientet e stërvitjeve - Infrastruktura minimale	22
Personeli dhe Kriteret Administrative	23
Neni 35 Zyrtari Administrativ	23
Neni 36 Zyrtari për media	23
Neni 37 Mjeku	23
Neni 38 Fizioterapeuti	23
Neni 39 Kryetrajneri i skuadrës së parë të femrave	24
Neni 40 Ndihmës-trajneri i skuadrës së parë të femrave	24
Neni 41 Trajneri i portiereve të skuadrës së parë të femrave	24
Neni 42 Trajnerët e ekipeve të të rinjve për femra	25
Neni 43 Dispozitat e zakonshme të zbatueshme për kualifikimet e trajnimit të UEFA-së	25
Neni 44 Kontratat me shkrim	26

Neni 45 Ofruesit e shërbimeve _____	26
Neni 46 Marrja e funksioneve _____	26
Neni 47 Struktura organizative _____	26
Neni 48 Detyra e zëvendësimit gjatë sezonit _____	26
Kriteret ligjore _____	27
Neni 49 Deklarata në lidhje me pjesëmarrjen në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra _____	27
Neni 50 Informacioni minimal ligjor _____	28
Neni 51 Kontrata me shkrim me një kompani futbollit _____	28
Neni 52 Struktura e grupit ligjor _____	29
Neni 53 Pala e fundit kontrolluese, përfituesi i fundit dhe pala me ndikim të rëndësishëm _____	30
Neni 54 Përfaqësimi me shkrim para vendimit për licencim _____	31
Kriteret financiare _____	31
Neni 55 Subjekti/subjektet raportuese dhe perimetri raportues _____	31
Neni 56 Pasqyrat financiare vjetore _____	32
Neni 57 Asnjë detyrim i prapambetur ndaj klubeve të futbollit _____	33
Neni 58 Asnjë detyrim i prapambetur ndaj punonjësve _____	34
Neni 59 Asnjë detyrim i prapambetur ndaj organeve shoqërore/tatimore _____	36
Neni 60 Asnjë detyrim i prapambetur në lidhje me UEFA-në dhe licencuesin _____	37
III - Dispozitat përfundimtare _____	38
Neni 61 Teksti autoritativ dhe gjuha e korrespondencës _____	38
Neni 62 Anekset _____	38
Neni 63 Kontrollat e përputhshmërisë _____	38
Neni 64 Procedurat disiplinore _____	38
Neni 65 Dispozitat e zbatimit _____	38
Neni 66 Miratimi, shfuqizimi dhe hyrja në fuqi _____	38
Neni 67 Dispozitat e jashtëzakonshme dhe kalimtare _____	39
Aneksi A - Politika e përjashtimeve _____	40
A.1 Parimet _____	40

A.2 Procesi	40
Aneksi B - Delegimi i përgjegjësive të licencimit në një ligë të lidhur	42
B.1 Parimet	42
Aneksi C - Integrimi i kritereve të licencimit të klubeve të Ligës së Kampionëve të UEFA-së për femra në rregulloret nacionale të licencimit të klubeve	43
C.1 Parimet	43
C.2 Procesi	43
Aneksi D - Aplikimi i jashtëzakonshëm i sistemit të licencimit të klubeve	45
D.1 Parimet	45
Aneksi E - Kërkesat për dhënie informacionesh për pasqyrat financiare	46
E.1 Parimet	46
E.2 Bilanci i gjendjes	46
E.3 Kontabiliteti i fitimit dhe humbjes	47
E.4 Pasqyra e rrjedhës së parasë	47
Aneksi F - Nocioni i detyrimeve të vonuara	49
F.1 Parimet	49
Aneksi G - Procedurat e vlerësimit të licencuesit	51
G.1 Parimet	51
G.2 Vlerësimi i raportit të auditorit mbi pasqyrat financiare	51
G.3 Vlerësimi i dokumentacionit të licencimit për mos-pagesa të prapambetura	52
G.4 Vlerësimi i përfaqësimit me shkrim përpara vendimit për licencim	53

Parathënie

Kjo rregullore është miratuar në bazë të nenit 50(1) të Statutit të UEFA-së.

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Fusha e zbatimit

- 1.01 Kjo rregullore është e zbatueshme në përputhje me referencën përkatëse në *Rregulloren e Ligës së Kampionëve të UEFA-së për Femra*.
- 1.02 Kjo rregullore rregullon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në sistemin e UEFA-së për licencimin e klubeve (Pjesa II) dhe përcakton në veçanti:
- kërkesat minimale që duhet të plotësohen nga një federatë anëtare e UEFA-së në mënyrë që të veprojnë si licencues për klubet e veta, si dhe procedurat minimale që duhet të ndiqen nga licencuesi në vlerësimin e tij/saj për kriteret e licencimit të klubeve (**Kapitulli 1**);
 - Aplikuesi për licencë dhe licenca e nevojshme për të hyrë në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për Femra (**Kapitulli 2**);
 - Minimumi i përgjegjësisë sociale sportive të futbollit, infrastrukturës, personelit dhe administrative, kriteret ligjore dhe financiare që duhet të përmbushë një klub në mënyrë që t'i jepet një licencë nga licencuesi i tij si pjesë e procedurës së pranimit për të hyrë në Ligën e Kampionëve të UEFA-s për Femra (**Kapitulli 3**).

Neni 2 Objektivat

- 2.01 Kjo rregullore synon:
- promovimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të standardit të të gjitha aspekteve të futbollit në Evropë dhe dhënien përparësi të vazhdueshme stërvitjes dhe mirëqenies së lojtareve të reja në çdo klub;
 - promovimin e pjesëmarrjes në futboll dhe për të kontribuar në zhvillimin e futbollit për femra;
 - sigurimin që klubet të kenë një nivel adekuat të menaxhimit dhe organizimit;
 - përshtatjen e infrastrukturës sportive të klubeve për t'iu ofruar lojtareve, spektatorëve dhe përfaqësuesve të mediave, ambiente të përshtatshme, të pajisura mirë dhe të sigurta;
 - mbrojtjen e integritetit dhe mbarëvajtjen e Ligës së Kampionëve të UEFA-së për Femra;
 - mbrojtjen e identitetit, historisë dhe trashëgimisë së çdo klubi;

- g. inkurajimin e bashkëpunimit ndërmjet licencuesve dhe klubeve dhe të mundësojë zhvillimin e standardeve për klubet në fushën financiare, sportive, juridike, përgjegjësinë sociale ndaj futbollit, personelin, kriteret administrative dhe të infrastrukturës në të gjithë Evropën;
- h. përqafimin e përgjegjësisë sociale në futboll;
- i. promovimin e një marrëdhënie të shëndetshme midis klubeve dhe mbështetësve dhe për të rritur qasjen në futboll.

Neni 3 Përgjegjësitë e Organit të UEFA-së për Kontrollin Financiar të Klubeve

- 3.01 Organi i UEFA-së për Kontrollin Financiar të Klubeve kryen detyrat e veta siç parashihet në këtë rregullore dhe në *Rregullat procedurale që rregullojnë Organin e UEFA-së për Kontrollin Financiar të Klubeve*.
- 3.02 Në kryerjen e këtyre përgjegjësiave, Organi i UEFA-së i Kontrollit Financiar të Klubeve siguron trajtim të barabartë të të gjithë licencuesve, aplikuesve për licenca dhe të licencuarve, dhe garanton konfidencialitetin e plotë të të gjithë informacionit të dhënë.

Neni 4 Përkufizimi i termave

- 4.01 Për qëllime të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

Procedurat e administrimit

Proces vullnetar ose i detyrueshëm që mund të përdoret si alternativë për likuidimin e një subjekti, shpesh i njohur si kalimi në administrim. Menaxhimi i përditshëm i aktiviteteve të një subjekti në administrim mund të bëhet nga administratori në emër të kreditorëve.

Agjent/ndërmjetës

Person fizik ose juridik i cili, me pagesë ose pa pagesë, përfaqëson lojtarët dhe/ose klubet në negociata me synimin për të lidhur kontratë pune ose përfaqëson klubet në negociata me synimin për të nënshkruar marrëveshje transferimi.

Procedurat e dakorduara

Procedura për të cilat është rënë dakord nga auditori dhe pala e angazhuar dhe, nëse është e nevojshme, nga palët e tjera.

Data e referencës vjetore të kontabilitetit

Datë në të cilën përfundon periudha e raportimit për pasqyrat financiare vjetore.

Bashkëpunëtor

Subjekt, që përfshirë një subjekt të pa-ikorporuar si një ortakëri, i cili nuk është as filial dhe as nuk ka interes në një sipërmarrje të përbashkët dhe mbi të cilën investitori ka ndikim të rëndësishëm.

Auditor

Firmë e pavarur auditimi që vepron në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë).

OUKFK

Organ i UEFA-së për Kontroll Financiar të Klubeve

Kriteret e licencimit të klubeve

Kërkesa, të ndara në gjashtë kategori (sportive, përgjegjësi sociale futbollit, infrastrukturë, personel dhe administrativ, ligjore dhe financiare), duhet të plotësohen nga një aplikues për licencë që t'i jepet një licencë.

Kërkesat për monitorim të klubeve

Kërkesa që duhen plotësuar nga një i licencuar i pranuar në Ligën e Kampionëve të UEFA-së, Europa Ligën e UEFA-së ose Europa Ligën e Konferencave të UEFA.

Kontrolli

Kompetenca për të kryer aktivitetet e një subjekti dhe për të drejtuar politikat e tij financiare, operative ose sportive, që ndikojnë në kthimet, me anë të pronësisë së aksioneve, fuqisë votuese, dokumenteve kushtetuese (statuteve), marrëveshjeve ose ndryshe.

Shembujt e kontrollit përfshijnë një palë:

- a. zotërimi i shumicës së të drejtave të votimit të aksionarëve ose anëtarëve;
- b. e drejta për të emëruar ose shkarkuar shumicën e anëtarëve të ngarkuar me qeverisjen e një subjekti (p.sh. organ administrativ, menaxherial ose mbikëqyrës të një subjekti);
- c. aksionar minoritar ose anëtar i subjektit dhe i vetëm, sipas një marrëveshje të lidhur me aksionarë të tjerë ose anëtarë të një subjekti ose me çdo mjet tjetër, ushtrimi i kontrollit (përfshirë ato siç janë të përcaktuara nën pikat (a) ose (b)).

Kostoja e regjistrimit të një lojtareje

Shumat e paguara ose pagesat që i atribuohen drejtpërdrejt regjistrimit të një lojtareje, përfshijnë:

- a. kompensim fiks të transferimit;
- b. kompensim të realizuar të kushtëzuar të transferit për shumat që janë paguar gjatë periudhës;
- c. çdo shumë tjetër që i atribuohet drejtpërdrejt pagesave dhe/ose që i paguhet një palë tjetër, si p.sh. një klubi tjetër futbollit, agjenti/ndërmjetësi ose federate/ligje kombëtare të futbollit.

Amortizimi

Ndarja sistematike e shumës së amortizueshme të një pasurie të prekshme gjatë jetëgjatësisë së saj, d.m.th. periudha gjatë së cilës një pasuri (aset) pritet të jetë e disponueshme për përdorim nga një subjekt.

I atribuuar drejtpërdrejt

I atribuuar drejtpërdrejt nënkupton, lidhur me një aktivitet të caktuar, që:

- a. Shpenzimi do të ishte shmangur në qoftë se nuk do të ishte ndërmarrë ai aktivitet i veçantë; dhe
- b. Shpenzimi është i identifikueshëm ndaras, pa ndarje.

Dividentat

Shpërndarje të paguara për bartësit e instrumenteve të kapitalit neto.

Shpenzimet e përfitimit të punonjësve

Të gjitha format e vlerësimit të dhëna nga një subjekt në këmbim të shërbimeve të ofruara nga punonjësit ose për ndërprerjen e punësimit, duke përfshirë atë në lidhje me drejtorët, menaxhmentin dhe ata të ngarkuar me qeverisjen.

Ngjarje ose gjendje me rëndësi të madhe ekonomike

Një ngjarje ose gjendje që konsiderohet e rëndësishme për pasqyrat financiare të subjektit/subjekteve raportuese dhe që do të kërkonte një paraqitje tjetër (të pafavorshme) të rezultateve të operimeve, pozicionit financiar dhe pasurive neto të një subjekti/subjekteve raportuese, nëse ka ndodhur gjatë periudhës së mëparshme raportuese ose gjatë periudhës së ndërmjetme.

Qeverisja

Çdo formë e qeverisjes, përfshirë agjencitë e qeverisë, departamentet qeveritare, subjektet qeveritare dhe organe të ngjashme, qofshin lokale apo qendrore.

Grupi

Një amë dhe të gjitha filialet e saj. Amë është një subjekt që ka një ose më shumë filiale. Një filial është një subjekt, përfshirë një subjekt të pa-inkorporuar siç është një ortakëri e cila kontrollohet nga një subjekt tjetër (i njohur si ëma).

Zhvlerësimi i pasurive të prekshme

Humbje nga zhvlerësimi që është shuma me të cilën vlera kontabël e një pasurie të prekshme tejkalon shumën e tij të rikuperueshme, d.m.th., sa më e lartë vlera e drejtë e një pasurie, kostoja më e ulët për ta shitur dhe për t'i dhënë vlerën në përdorim.

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)

Standarde dhe Interpretime të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ato përfshijnë:

- a. Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- b. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit; dhe

- c. Interpretimet e nxjerra nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar (KNIRF) ose nga ish-Komiteti i Interpretimeve të Përhershme (KIP).

SNSN (ISRS) 4400

Standardi Ndërkombëtar për Shërbimet e Ndërlidhura 4400 (i rishikuar), Angazhimet e Procedurave të Dakorduara.

Kontroll i përbashkët

Ndarje e dakorduar kontraktuale e kontrollit mbi një aktivitet ekonomik, e cila ekziston vetëm kur vendimet strategjike financiare dhe operative lidhur me aktivitetin kërkojnë pëlqim unanim të palëve që ndajnë kontrollin (sipërmarrësit).

Ndërmarrje e përbashkët

Marrëveshje kontraktuale ku dy ose më shumë palë ndërmarrin një aktivitet ekonomik që i nënshtrohet kontrollit të përbashkët.

Personeli kryesor i menaxhimit

Persona që kanë autoritet dhe përgjegjësi për planifikimin, drejtimin dhe kontrollimin e aktiviteteve të një subjekti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke përfshirë por jo të kufizuar në ndonjë drejtor (ekzekutiv ose jo) të subjektit.

Licencë

Certifikatë e dhënë nga licencuesi që konfirmon përmbushjen e të gjitha kriterëve minimale nga Aplikuesi për licencë si pjesë e procedurës së pranimit për të hyrë në garat e klubeve të UEFA-së.

Sezoni i licencës

Sezon i UEFA-së për të cilin një aplikues për licencë ka paraqitur kërkesë/i është dhënë një licencë. Ai fillon të nesërmen pas afatit për dorëzimin në UEFA, të listës së vendimeve të licencimit nga licencuesi dhe zgjat deri në të njëjtin afat të vitit pasues.

I licencuari

Paraqitës i kërkesës për licencë që i jepet licencë nga licencuesi.

Licencuesi

Federatë anëtare e UEFA-së ose ligë e saj që operon me sistemin e licencimit të klubeve, jep licenca dhe ndërmerr detyra të caktuara sa i përket procesit të monitorimit të klubeve.

Lista e vendimeve të licencimit

Listë e dorëzuar në UEFA nga licencuesi që përmban, mes tjerash, të dhëna rreth aplikuesve për licenca të cilët i nënshtrohen procesit të licencimit dhe që iu jepen ose iu refuzohen licenca nga organet nacionale të vendimmartjes në formatin e vendosur dhe të komunikuar nga UEFA.

Material/Materialiteti

Gabime ose keq-deklarime të artikujve ose informacioneve janë materiale nëse ato mund të ndikojnë individualisht ose kolektivisht në vendimet e përdoruesve, të marra në bazë të informacionit të paraqitur nga klubi. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e gabimit/lëshimit ose keq-deklarimit të gjykuar në rrethanat ose kontekstin përreth. Madhësia ose natyra e artikullit ose informacionit, ose një kombinim i të dyjave, mund të jetë faktori përcaktues.

Kriteret minimale

Kritere që duhet të plotësohen nga Aplikuesi për licencë në mënyrë që t'i jepet licenca.

Dokumentacioni i monitorimit

Dokumentacion që duhet të paraqitet nga një i licencuar siç përcaktohet, lidhur me secilën kërkesë të monitorimit të klubeve.

Praktika nacionale e kontabilitetit

Praktikë e kontabilitetit dhe e raportimit dhe dhënie e informacionit shpjegues që kërkohen nga subjektet në një vend të caktuar.

Borxhi neto

Përmbledhje e bilanceve të mëposhtme:

- mbitërheqjet bankare, huatë bankare dhe të tjera, llogaritjet e pagesave ndaj subjekteve të grupit dhe palëve të tjera të ndërlidhura, më pak para të gatshme dhe ekuivalentët e saj;
- bilanci neto i transfereve të lojtareve, d.m.th. neto e llogarive të arkëtueshme nga transferet e lojtareve dhe llogarive të pagesave nga transferet e lojtareve; dhe
- llogaritë e pagesave ndaj autoriteteve shoqërore/tatimore (jo rrjedhëse).

Rezultati neto

Totali i të gjithë artikujve të të ardhurave minus shpenzimet në një periudhë, në fitim ose humbje.

Palët e përfshira

Çdo person ose subjekt i përfshirë në sistemin UEFA-së të licencimit të klubeve ose në procesin e monitorimit të klubeve, duke përfshirë administratën e UEFA-së, OUKFK, licencuesin, aplikuesin për licencë/të licencuarin dhe çdo individ të përfshirë në emër të tyre.

Palë

Person fizik ose juridik, subjekt ligjor ose qeveri.

Regjistrimi(et) i lojtareve

Regjistrimi(et) i lojtareve ka kuptimin e paraparë në *Rregulloren e FIFA-së për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve*.

Fitimi/humbja nga heqja nga përdorimi i aseteve të prekshme

Fitim ose humbje e llogaritur si diferencë ndërmjet të ardhurave neto nga nxjerrja jashtë përdorimit, nëse ka, dhe vlerës kontabël (sipas bilancit) të pasurisë (asetit) së prekshme në datën e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Mbrojtje nga kreditorët

Procedurë në përputhje me ligjet ose rregulloret, objektivat e të cilave janë të mbrojnë një subjekt nga kreditorët, të shpëtojnë subjektet e falimentuara dhe t'i lejojnë ato të vazhdojnë drejtimin e biznesit të tyre në vazhdimësi. Ky proces përfshin procedura (vullnetare) të likuidimit ose administrimit dhe procedura të tjera të falimentimit (që do të mund të rezultojnë në kompromis me kreditorët ose në falimentim).

Palë e ndërlidhur

Palë e ndërlidhur është një person ose subjekt ose qeveri që është i/e lidhur me subjektin që po përgatit pasqyrat e tij/saj financiare (subjekti raportues). Në shqyrtimin e çdo marrëdhënieje të mundshme të palës së ndërlidhur, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

- a. Person ose anëtar i ngushtë i familjes së atij personi është i lidhur me një subjekt raportues nëse ai person:
 - i. ka kontroll ose kontroll të përbashkët të subjektit raportues;
 - ii. ka ndikim të rëndësishëm mbi subjektin raportues; ose
 - iii. është anëtar i personelit drejtues kryesor të subjektit raportues ose i një subjekti raportues amë.
- b. Një subjekt është i lidhur me një subjekt raportues nëse zbatohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:
 - i. Subjekti dhe subjekti raportues janë anëtarë të të njëjtit grup (që do të thotë se çdo njësi amë, filial dhe filial tjetër është i lidhur me të tjerët).
 - ii. Subjekti dhe subjekti raportues kontrollohen, kontrollohen bashkërisht ose janë të ndikuar ndjeshëm nga e njëjta palë.
 - iii. Një subjekt është bashkëpjesëmarrës ose ndërmarrje e përbashkët e subjektit tjetër (ose një ndërmarrje, ose ndërmarrje e përbashkët e një anëtari të një grupi nga i cili subjekti tjetër është anëtar).
 - iv. Një palë ka ndikim të rëndësishëm mbi subjektin tjetër.
 - v. Të dyja subjektet janë ndërmarrje të përbashkëta të së njëjtës palë të tretë.

- vi. Një subjekt është ndërmarrje e përbashkët e një subjekti të tretë dhe subjekti tjetër është një bashkëpunëtor i subjektit të tretë.
- vii. Subjekti është një skemë përfitimesh pas-punësimit në dobi të punonjësve të subjektit raportues ose të një subjekti të lidhur me subjektin raportues. Nëse subjekti raportues është vetë një plan i tillë, po ashtu edhe punëdhënësit sponsorizues janë të lidhur me subjektin raportues.
- viii. Subjekti kontrollohet ose kontrollohet bashkërisht nga një person i identifikuar si në pikën a).
- ix. Një person i identifikuar si në pikën (a)(i) ka ndikim të rëndësishëm mbi subjektin ose është anëtar i personelit drejtues kryesor të subjektit (ose i një subjekti amë).
- x. Subjekti, ose çdo anëtar i një grupi, pjesë e të cilit është, ofron shërbimet kyçe të personelit të menaxhimit për subjektin raportues ose për subjektin amë të subjektit raportues.

Subjektet/entitetet raportuese

Një anëtar i regjistruar ose kompani futbollit ose grup subjektësh ose ndonjë kombinim tjetër subjektësh të përfshirë në perimetrin e raportimit dhe që duhet t'i sigurojë licencuesit informacion për qëllime të licencimit dhe monitorimit të klubit.

Periudha e raportimit

Periudhë e raportimit financiar që përfundon në datën e referencës së kontabilitetit vjetor të subjektit raportues.

Ndryshimi i rëndësishëm

Ngjarje që konsiderohet e rëndësishme për dokumentacionin e dorëzuar më parë të licencuesit dhe që do të kërkonte paraqitje ndrysh nëse do të ndodhte para dorëzimit të dokumentacionit.

Ndikim i rëndësishëm

Kompetencë për të marrë pjesë në politikën financiare, operative ose sportive të një subjekti, por jo nën kontrollin ose kontrollin e përbashkët të atij subjekti, me anë të pronësisë së aksioneve, fuqisë votuese, dokumenteve kushtetuese (statuteve), marrëveshjes ose të tjera.

Shembuj të ndikimit të rëndësishëm përfshijnë një palë:

- a. që zotëron drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndërmjet 20% dhe 50% të të drejtave të votimit të aksionarëve ose anëtarëve;
- b. që ka aftësinë për të ndikuar në emërimin ose largimin e shumicës së anëtarëve të ngarkuar me qeverisjen e një subjekti (p.sh. çdo organ administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të një subjekti);
- c. që është aksionar i vogël ose anëtar i subjektit dhe i vetëm, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur me aksionarë të tjerë ose anëtarë të një subjekti ose me çdo mjet tjetër, që është në gjendje të ushtrojë ndonjë ndikim të rëndësishëm (përfshirë edhe atë që përcaktohet në pikat a) dhe b);

- d. që ofron në një periudhë raportimi qoftë vetëm ose në përgjithësi me palët nën të njëjtën palë apo qeveri kontrolluese të fundit (me përjashtim të UEFA-së, federatës anëtare të UEFA-së dhe një ligë) një shumë të barabartë me të paktën 30% të të ardhurave totale të subjektit për të njëjtën periudhë.

Stadiumi

Vend për ndeshje kompeticioni duke përfshirë, por pa u kufizuar në të, të gjitha pronat dhe ambientet përreth (për shembull zyrat, zonat e mikpritjes, qendrën e shtypit dhe qendrën e akreditimit).

Informacione plotësuese

Informacion financiar që duhet t'i dorëzohet licencuesit përveç pasqyrave financiare nëse nuk plotësohen kërkesat minimale për dhënie informacionesh shpjeguese dhe kontabiliteti. Informacioni plotësues duhet të përgatitet në bazë të kontabilitetit dhe politikave kontabël, në përputhje me pasqyrat financiare. Informacioni financiar duhet të nxirret nga burime në përputhje me ato që përdoren për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore. Kur është e përshtatshme, dhënia e informacioneve shtesë duhet të dakordohet ose të jetë në pajtim me dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare.

Asetet e prekshme

Asete që kanë substancë fizike dhe mbahen për përdorim në prodhimin ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'u dhënë me qira ose për qëllime administrative, në mënyrë të vazhdueshme në aktivitetet e subjektit ekonomik.

Ambientet e stërvitjeve

Vend(e) në të cilin lojtarët e regjistruar të një klubi kryejnë stërvitje të rregullta futbollit ose aktivitete të zhvillimit të të rinjve.

Standardi i UEFA-së i cilësisë së licencimit të klubeve

Dokument që përcakton kërkesat minimale me të cilat licencuesit duhet të jenë në përputhje për të operuar me sistemin e licencimit të klubeve.

Pala e fundit kontrolluese

Person fizik ose juridik i cili ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kontrollin përfundimtar të një subjekti.

4.02 Në këtë rregullore, përdorimi i formës mashkullore i referohet njëloj edhe asaj femërore.

II Licencimi i klubeve nga UEFA

Kapitulli 1 – Licencuesi

Neni 5 Përgjegjësitë e licencuesit

- 5.01 Licencuesi është një federatë anëtare e UEFA-së që qeveris me sistemin e licencimit të klubeve.
- 5.02 Sipas disa kushteve të caktuara të përcaktuara në Aneksin B, një federatë anëtare e UEFA-së mund t'ia delegojë sistemin e licencimit të klubeve ligës së saj të lidhur. Paralel me UEFA-në, federata anëtare e UEFA-së mbetet përgjegjëse dhe e ngarkuar për zbatimin e duhur të sistemit të licencimit të klubeve, pavarësisht nëse ka apo jo delegim.
- 5.03 Licencuesi duhet të sigurojë që të gjitha dispozitat e zbatueshme të përcaktuara në pjesën II të kësaj rregulloreje, të jenë të integruara në rregulloret nacionale të licencimit të klubeve, të cilat duhet t'i dorëzohen UEFA-së në një nga gjuhët zyrtare të UEFA-së për shqyrtim, sipas procedurës të përcaktuar në Aneksin C.
- 5.04 Në veçanti licencuesi duhet të:
- krijojë një administratë të përshtatshme licencimi siç përcaktohet në Nenin 6;
 - formojë të paktën dy organe vendimmarrëse sipas Nenit 7;
 - përpilojë një katalog të sanksioneve sipas Nenit 8;
 - përkufizojë procesin bazë sipas Nenit 10;
 - shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi për licencë, të vlerësojë nëse është e përshtatshme dhe të përcaktojë procedurat e vlerësimit në përputhje me Nenin 11;
 - sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë aplikuesve për licenca dhe t'iu garantojë atyre konfidencialitet të plotë sa i përket të gjithë informacionit të ofruar gjatë procesit të licencimit, siç përcaktohet në Nenin 12;
 - përcaktojë nëse secili kriter është përmbushur dhe çfarë informacioni të mëtejshëm, nëse ka, nevojitet për dhënien e licencës.

Neni 6 Administrimi i licencimit

- 6.01 Licencuesi duhet të emërojë një menaxher licencimi i cili është përgjegjës për administrimin e licencimit.
- 6.02 Detyrat për administrimin e licencimit përfshijnë:

- a. përgatitja, zbatimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të licencimit të klubeve;
- b. ofrimi i mbështetjes administrative për organet vendimmarrëse;
- c. asistimi, këshillimi dhe monitorimi i të licencuarve gjatë sezonit;
- d. informimi i UEFA-së për çdo ngjarje që ndodh pas vendimit të licencimit që përbën një ndryshim të rëndësishëm në informacionin e paraqitur më parë të licencuesit, duke përfshirë ndryshim të formës ligjore, strukturës së grupit ligjor (përfshirë ndryshimin e pronësisë) ose identitetin;
- e. duke shërbyer si pikë kontakti dhe për të ndarë ekspertizën me departamentet e licencimit të federatave të tjera anëtare të UEFA-së dhe me vetë UEFA-në.

6.03 Të paktën një anëtar i administratës së licencimit ose një ekspert i jashtëm financiar duhet të ketë përvojë financiare dhe një diplomë në kontabilitet/auditim të njohur/pranuar nga organi përkatës shtetëror (p.sh. shoqata tregtare kombëtare), ose duhet të ketë disa vite përvojë në çështjet e mësipërme ("pranim/njohje e kompetencës").

Neni 7 Organet vendimmarrëse

7.01 Organet vendimmarrëse janë Organi i Shkallës së Parë dhe Organi i Apelit dhe ata duhet të jenë të pavarur nga njëri-tjetri.

7.02 Organi i Shkallës së Parë vendos nëse duhet t'i jepet një licencë një aplikuesi për licencë në bazë të dokumentacionit të paraqitur brenda afatit të përcaktuar nga licencuesi dhe nëse një licencë duhet të tërhiqet/të merret.

7.03 Organi i Apelit vendos për ankesat e paraqitura me shkrim dhe merr vendim të formës së prerë nëse një licencë duhet të jepet apo të merret/tërhiqet.

7.04 Ankesat duhet të parashtrohen nga:

- a. një aplikues për licencë të cilit i refuzohet kërkesa për licencë nga Organi i Shkallës së Parë;
- b. një i licencuar licenca e të cilit është tërhequr/marrë nga Organi i Shkallës së Parë; ose
- c. menaxheri i licencimit në emër të licencuesit.

7.05 Organi i Apelit merr vendimin e vet në bazë të vendimit të Organit të Shkallës së Parë dhe në bazë të të gjitha dëshmive të ofruara nga parashtruesi i ankesës me kërkesën e vet me shkrim për ankesë dhe brenda afatit të caktuar.

7.06 Nëse një federatë anëtare e UEFA-së ka një gjykatë arbitrazhi të specifikuar në statutin e vet, kjo gjykatë vendos nëse sistemi i licencimit të klubeve është nën autoritetin e saj. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet afateve përkatëse për hyrjen në garat e klubeve të UEFA-së.

7.07 Anëtarët e organeve vendimmarrëse zgjidhen ose emërohen në përputhje me statutet e federatave anëtare të UEFA-së dhe duhet:

- a. të veprojnë në mënyrë të paanshme në kryerjen e detyrave të tyre;
- b. të abstenojnë, nëse ka ndonjë dyshim për pavarësinë e tyre nga aplikuesi për licencë ose nëse ka konflikt interesi. Në lidhje me këtë, pavarësia e një anëtari nuk mund të garantohet nëse ai/ajo ose ndonjë anëtar i familjes së tij/saj (bashkëshorti, fëmija, prindi ose vëllai ose motra) është anëtar, aksionar, partner biznesi, sponsor ose konsulent i aplikuesit për licencë.
- c. të mos veprojnë njëkohësisht si menaxher licencimi ose anëtar i administratës së licencimit;
- d. të mos i përkasin njëkohësisht një organi statutor juridik të licencuesit;
- e. të mos i përkasin njëkohësisht organit ekzekutiv të federatës anëtare të UEFA-së ose ligës së saj;
- f. të mos i përkasin njëkohësisht personelit të një klubi të lidhur;
- g. të përfshijë të paktën një jurist të kualifikuar dhe një ekspert financiar të kualifikuar, të njohur nga organi përkatës profesional shtetëror.

7.08 Kuorumi i organeve vendimmarrëse duhet të jetë së paku tre anëtarë. Në rast të barazimit, votën vendimtare e ka kryesuesi.

7.09 Organet vendimmarrëse duhet të veprojnë sipas rregullave procedurale – që përcaktohen nga licencuesi – që, minimalisht, duhet të rregullojnë standardet e mëposhtme:

- a. Afatet (p.sh. afati i dorëzimit, etj.)
- b. Masat mbrojtëse të parimit të trajtimit të barabartë
- c. Përfaqësimi (p.sh. përfaqësimi ligjor, etj.)
- d. E drejta për t'u dëgjuar (p.sh. mbledhje, seancë dëgjimore)
- e. Gjuha zyrtare (nëse është e aplikueshme)
- f. Afati kohor për kërkesa (p.sh. llogaritja, pajtueshmëria, ndërprerja, zgjatja)
- g. Afati kohor për ankim
- h. Efektet e ankimimit (p.sh. pa efekt vonues)
- i. Lloji i provës së kërkuar
- j. Barra e provës (p.sh. aplikuesi për licencë ka barrën e provës)
- k. Vendimi (p.sh. me shkrim me arsyetim, etj.)
- l. Baza për ankesa
- m. Përmbajtja dhe forma e ankesës
- n. Seancat shqyrtuese/dëgjimore
- o. Kostoja e procedurës/tarifa administrative/depozita

Neni 8 Katalogu i sanksioneve

- 8.01 Për të garantuar një proces të duhur vlerësimi, licencuesi duhet:
- të krijojë një katalog sanksionesh për sistemin e licencimit të klubeve për mosrespektim të kriterëve të përmendura në Paragrafin 18.02, të cilat mund të përfshijnë vërejtje, gjobë, detyrim për paraqitjen e provave ose plotësimin e kushteve të caktuara nga një afat i caktuar etj. I takon organeve kompetente nacionale të vendosin këto sanksione për aplikuesit për licenca/licensuesit;
 - ti referohet rregulloreve nacionale disiplinore në lidhje me shkeljet e rregulloreve të tjera të licencimit (p.sh. dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, mosrespektimi i afateve, sanksionet ndaj individëve, etj.).

Neni 9 Certifikimi i licencuesit

- 9.01 Licencuesi duhet të certifikohet çdo vit nga një organ i pavarur i caktuar nga UEFA në bazë të *Standardit të Cilësisë të UEFA-së për Licencimin e Klubeve*.

Neni 10 Procesi bazë

- 10.01 Licencuesi duhet të përcaktojë procesin bazë për verifikimin e kriterëve të licencimit të klubeve dhe në këtë mënyrë të menaxhojë dhënien e licencave.
- 10.02 Procesi bazë fillon në një kohë të përcaktuar nga licencuesi dhe përfundon me dorëzimin në UEFA të listës së vendimeve të licencimit brenda afatit të komunikuar nga kjo e fundit.
- 10.03 Procesi bazë përbëhet nga hapat minimalë kryesorë si më poshtë:
- Dorëzimi i dokumentacionit të licencimit tek aplikuesit për licencë;
 - Kthimi i dokumentacionit të licencimit te licencuesi;
 - Shqyrtimi i dokumentacionit nga administrata e licencimit;
 - Dorëzimi i përfaqësimit me shkrim te licencuesi;
 - Vlerësimi dhe vendimi nga organet vendimmarrëse;
 - Dorëzimi në UEFA i çdo vendimi të formës së prerë brenda shtatë ditëve.
- 10.04 Afatet për hapat kyç të procesit të mësipërm duhet të përcaktohen qartë dhe t'iu komunikohen klubeve në fjalë përpara fillimit të procesit bazë nga licencuesi.

Neni 11 Procedurat e vlerësimit

- 11.01 Licencuesi përcakton procedurat e vlerësimit, përveç atyre që përdoren për të verifikuar përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara për të cilat duhet të ndiqen procese specifike vlerësimi, siç përcaktohet në Aneksin I.

Neni 12 Trajtimi i barabartë dhe konfidencialiteti

- 12.01 Licencuesi siguron trajtim të barabartë të të gjithë aplikuesve për licencë gjatë procesit bazë.
- 12.02 Licencuesi u garanton aplikuesve për licencë konfidencialitet të plotë në lidhje me të gjithë informacionin e paraqitur gjatë procesit të licencimit. Çdo person i përfshirë në procesin e licencimit ose i emëruar nga licencuesi duhet të nënshkruajë një marrëveshje konfidencialiteti përpara se të marrin përsipër detyrat e tyre.

Neni 13 Politika e përjashtimeve

- 13.01 UEFA mund të bëjë përjashtim nga dispozitat e përcaktuara në Pjesën II brenda kufijve të përcaktuar në Aneksin A.

Kapitulli 2: Aplikuesi për licencë dhe licenca

Neni 14 Përkufizimi i aplikuesit për licencë dhe rregulli tre-vjeçar

- 14.01 Aplikues për licencë mund të jetë vetëm një klub futbollit, d.m.th. një person juridik plotësisht dhe i vetëm përgjegjës për një ekip futbollit që merr pjesë në garat nacionale dhe ndërkombëtare të klubeve, i cili ose:
- është anëtar i regjistruar i një federate anëtare e UEFA-së dhe/ose i një lige të saj (në tekstin e mëtejshëm: anëtar i regjistruar); ose
 - ka marrëdhënie kontraktuale me një anëtar të regjistruar (në tekstin e mëtejshëm: kompani futbollit).
- 14.02 Deri në fillimin e sezonit të licencës, anëtarësimi dhe/ose marrëdhënia kontraktuale (nëse ka) duhet të ketë zgjatur për të paktën tre sezona radhazi. Për më tepër, aplikuesi për licencë duhet të ketë marrë pjesë në garat zyrtare për të paktën tre sezona radhazi (në tekstin e mëtejshëm: rregulli trevjeçar).
- 14.03 Çdo ndryshim në formën ligjore, strukturën e grupit ligjor (përfshirë bashkimin me një subjekt tjetër ose transferimin e aktiviteteve të futbollit tek një subjekt tjetër) ose identitetin (përfshirë selinë, emrin ose ngjyrat) e një aplikuesi për licencë/licencues, duhet të njoftohet licencuesi dhe UEFA, përpara fillimit të procesit të licencimit.
- 14.04 Çdo ndryshim në formën ligjore, strukturën e grupit ligjor (përfshirë bashkimin me një subjekt tjetër ose transferimin e aktiviteteve të futbollit te një subjekt tjetër) ose identitetin (duke përfshirë selinë, emrin ose ngjyrat) e një aplikuesi për licencë /licencues, që është zhvilluar brenda tre sezoneve para fillimit të sezonit të licencës në dëm të integritetit të një gare; ose për të lehtësuar kualifikimin e aplikuesit për licencë për një garë, në bazë të meritave sportive; ose për të lehtësuar marrjen e licencës, konsiderohet si ndërprerje e anëtarësimit ose marrëdhënies kontraktuale (nëse ka) sipas kuptimit të kësaj dispozite.
- 14.05 Përjashtimet nga rregulli tre-vjeçar mund të bëhen nga Organi i UEFA-së për Kontroll Financiar të Klubeve (OKFK) në përputhje me Aneksin A.

Neni 15 Përgjegjësitë e përgjithshme të aplikuesit për licencë

- 15.01 Aplikuesi për licencë duhet t'i ofrojë licencuesit:
- të gjithë informacionin e nevojshëm dhe dokumentet përkatëse për të demonstruar plotësisht se detyrimet e licencimit janë përmbushur; dhe
 - dokumente të tjera të rëndësishme për vendimmarrje nga licencuesi.
- 15.02 Kjo përfshin informacion mbi subjektin/subjektet raportuese në lidhje me të cilat kërkohet të jepet informacioni sportiv, i përgjegjësive sociale të futbollit, të infrastrukturës, të personelit dhe administrativ, ligjor dhe financiar.
- 15.03 Çdo ngjarje që ndodh pas dorëzimit të dokumentacionit të licencimit të licencuesi dhe paraqet ndryshim të rëndësishëm në informacionin e paraqitur më parë, licencuesi duhet të njoftohet me shkrim menjëherë (përfshirë ndonjë ndryshim të formës ligjore të aplikuesit për licencë, të strukturës së grupit ligjor, duke përfshirë pronësinë ose identitetin).

Neni 16 Licenca

- 16.01 Klubet të cilat kualifikohen për në garat e UEFA-së për klube, me meritë sportive, sigurojnë një licencë të lëshuar nga licencuesit e tyre sipas rregulloreve nacionale të licencimit, përveç kur aplikohet Neni 17.
- 16.02 Një licence i skadon afati pa paralajmërim paraprak në fund të sezonit për të cilin ajo është lëshuar.
- 16.03 Një licencë nuk mund të bartet.
- 16.04 Një licencë mund të merret (tërhiqet) nga organet vendimmarrëse të licencuesit nëse:
- më nuk përmbushen asnjë nga kushtet për lëshimin e një licence; ose
 - licenca shkel ndonjë nga detyrimet e veta sipas rregulloreve nacionale për licencim të klubeve.
- 16.05 Sapo të parashikohet tërheqja e licencës, licencuesi duhet të informojë UEFA-në në përputhje me rrethanat.

Neni 17 Leja e posaçme

- 17.01 Nëse një klub kualifikohet për një garë të UEFA-së për klube, me merita sportive, por nuk i është nënshtruar fare procesit të licencimit ose i është nënshtruar një procesi licencimi i cili është më i vogël/jo ekuivalent me atë që aplikohet për klubet e divizionit të lartë për të hyrë në garat e UEFA-së për klube, sepse i përket një divizioni tjetër nga divizioni i lartë, licencuesi i klubit në fjalë mundet - në emër të atij klubi - të kërkojë aplikim të jashtëzakonshëm të sistemit të licencimit të klubeve në përputhje me Aneksin D.
- 17.02 Bazuar në një aplikim të tillë të jashtëzakonshëm, UEFA mund t'i japë leje të posaçme klubit për të hyrë në kompeticionin përkatës të UEFA-së por duke iu nënshtruar rregulloreve përkatëse të UEFA-së për garat e klubeve. Një aplikim i tillë i jashtëzakonshëm vlen vetëm për klubin specifik dhe për sezonin në fjalë.

Kapitulli 3: Kriteret për licencim të klubeve

Neni 18 Të përgjithshme

- 18.01 Me përjashtim të atyre në paragrafin 2 më poshtë, kriteret e përcaktuara në këtë kapitull duhet të plotësohen nga klubet në mënyrë që atyre t'u jepet licenca për të hyrë në Ligën e Kampionëve të UEFA-së, Ligën e Evropës të UEFA-së ose në Europa Ligën e Konferencave të UEFA-së (garat përkatëse).
- 18.02 Mosplotësimi i kriterëve të përcaktuara në Nenin 21, Nenin 24 deri në Nenin 32, Nenin 35, Nenin 42, Nenin 44 deri në Nenin 46, Nenin 52 dhe Nenin 54 deri në Nenin 58 dhe paragrafit 22.02 dhe paragrafit 24.02, nuk çon në refuzimin e licencës por në një sanksion të përcaktuar nga licencuesi sipas katalogut të tij të sanksioneve (shih nenin 8).

Kriteret sportive

Neni 19 Programi zhvillimor i të rinjve

- 19.01 Aplikuesi për licencë duhet ta ketë një program zhvillimor të të rinjve të miratuar nga licencuesi.
- 19.02 Programi duhet të përfshijë të paktën këto fusha:
- a. Promovimin e futbollit të femrave
 - b. Objektivat zhvillimore të të rinjve dhe filozofinë
 - c. Organizimin e sektorit të të rinjve (skemën organizative, organet e përfshira, relacionin me aplikuesin për licencë, ekipet e të rinjve, etj.)
 - d. Personelin (teknik, mjekësor, administrativ, etj.) dhe kualifikimet e tyre minimale të kërkuara
 - e. Infrastrukturën (ambientet për stërvitje dhe për ndeshje, disponueshmërinë e tyre, etj.)
 - f. Burimet financiare (buxhetin, kontributin nga aplikuesi për licencë, lojtarët ose komunitetin vendor, etj.)
 - g. Edukimin futbollistik për grupe të moshave të ndryshme (aftësitë për lojë, teknike, taktike dhe fizike).
 - h. Iniciativat edukuese (Ligjet e Lojës; anti-dopingun; integritetin, anti-racizmin)
 - i. Mbështetjen mjekësore për lojtarë të rinj (duke përfshirë mbajtjen e shënimeve mjekësore)
 - j. Procesin e rishikimit dhe reagimit për të vlerësuar rezultatet dhe arritjet kundrejt objektivave

- k. Kohëzgjatjen e programit (të paktën tri dhe më së shumti shtatë vite).

19.03 Aplikuesi për licencë gjithashtu siguron që:

- a. çdo lojtar i ri i përfshirë në programin e tij të zhvillimit të rinjve, mund të ndjek arsimin e detyrueshëm shkollor në përputhje me ligjin nacional; dhe
- b. asnjë lojtar i ri i përfshirë në programin e tij të zhvillimit të rinjve nuk pengohet të vazhdojë edukimin e tij jo-futbollistik.

Neni 20 Ekipet e të rinjve për femra

- 20.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të paktën dy ekipe të rinjve për femra brenda moshës prej 12 deri 21 vjeç.
- 20.02 Secili ekip i të rinjve për femra, brenda këtyre grup-moshave, duhet të merr pjesë në gara zyrtare ose programe të luajtura në nivel qendror, rajonal ose lokal dhe të jenë të pranuar nga federata anëtare e UEFA-së.

Neni 21 Kujdesi mjekësor i lojtarëve

- 21.01 Aplikuesi për licencë duhet të krijojë dhe të zbatojë një politikë për të siguruar që të gjithë lojtarët që kanë të drejtë të luajnë për skuadrën e parë të femrave, t'i nënshtrohen një ekzaminimi mjekësor vjetor në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregulloreve Mjekësore të UEFA-së.
- 21.02 Aplikuesi për licencë duhet të krijojë dhe zbatojë një politikë për të siguruar që të gjithë lojtarët e rinj mbi moshën 12 vjeç, t'i nënshtrohen një ekzaminimi mjekësor vjetor në përputhje me dispozitat përkatëse të përcaktuara nga licencuesi i tij në përputhje me legjislacionin e tij shtetëror.

Neni 22 Regjistrimi i lojtarëve

- 22.01 Të gjithë lojtarët e aplikuesit për licencë mbi moshën 12 vjeç, duhet të regjistrohen në federatën anëtare të UEFA-së ose në ligën e saj, në përputhje me dispozitat përkatëse të *Rregullores së FIFA-së mbi Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve*.

Neni 23 Kontrata me shkrim me lojtarë profesionistë

- 23.01 Secili nga lojtarët profesionistë të aplikuesit për licencë duhet të ketë një kontratë me shkrim me aplikuesin për licencë, në përputhje me dispozitat përkatëse të *Rregullores së FIFA-së mbi Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve*.

Neni 24 Huazimi i lojtarëve profesionistë

- 24.01 Aplikuesi për licencë duhet të respektojë dispozitat e *Rregullores së FIFA-së mbi Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve* sa i përket huazimit të lojtarëve profesionistë.

Neni 25 Çështjet e referimit dhe Ligjet e Lojës

- 25.01 Aplikuesi për licencë duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët e skuadrës së parë të femrave (lojtare, trajnerë dhe staf tjetër teknik) të marrin pjesë në një seancë ose në një ngjarje të referimit, të organizuar nga/ose në bashkëpunim me federatën anëtare të UEFA-së gjatë 12 muajve para sezonit të licencës.

Kriteret e përgjegjësisë sociale të futbollit

Neni 26 Strategjia e përgjegjësisë sociale të futbollit

- 26.01 Aplikuesi për licencë duhet të krijojë dhe zbatojë një strategji të përgjegjësisë sociale të futbollit në përputhje me *Strategjinë e UEFA-së për Qëndrueshmërinë e Futbollit 2030* dhe udhëzimet përkatëse të UEFA-së, të paktën për fushat e barazisë dhe përfshirjes, anti-racizmit, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve, futbollit për të gjitha aftësitë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 27 Barazia dhe përfshirja

- 27.01 Aplikuesi për licencë duhet të krijojë dhe zbatojë një politikë për të siguruar të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë njerëzit që ndjekin dhe kontribuojnë në aktivitetet e futbollit, të organizuara nga aplikuesi për licencë.

28 Anti-racizmi

- 28.01 Aplikuesi për licencë duhet të krijojë dhe zbatojë një politikë për të luftuar racizmin dhe për të garantuar që të gjitha politikat, programet dhe praktikat e aplikuesit për licencë të ushtrohen pa asnjë lloj diskriminimi.

Neni 29 Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve dhe e të rinjve

- 29.01 Aplikuesi për licencë duhet të krijojë dhe zbatojë një politikë për të mbrojtur, ruajtur dhe siguruar mirëqenien e lojtarëve të rinj dhe të sigurojë që ata të jenë në një mjedis të sigurt kur marrin pjesë në aktivitete të organizuara nga aplikuesi për licencë.

Neni 30 Futbolli për të gjitha aftësitë

- 30.01 Aplikuesi për licencë duhet të krijojë dhe zbatojë një politikë për ta bërë ndjekjen dhe kontributin në aktivitetet e futbollit të organizuara nga aplikuesi për licencë, të qasshme dhe të këndshme për të gjithë, pavarësisht nga paaftësia ose faktorët e paaftësisë.

Neni 31 Mbrojtja e mjedisit

- 31.01 Aplikuesi për licencë duhet të krijojë dhe zbatojë një politikë për të përmirësuar gjurmët e tij në mjedis dhe qëndrueshmërinë në lidhje me organizimin e ngjarjeve, ndërtimin dhe menaxhimin e infrastrukturës.

Kriteret e infrastrukturës

Neni 32 Stadiumi për Ligën e Kampionëve të UEFA-së për Femra

- 32.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë në dispozicion një stadium për Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra, i cili duhet të jetë brenda territorit të federatës anëtare të UEFA-së dhe i miratuar nga federata anëtare e UEFA-së në përputhje me *Rregulloren e UEFA-së për Infrastrukturën e Stadiumit*.
- 32.02 Nëse Aplikuesi për licencë nuk është pronar i një stadiumi, ai duhet të sigurojë një kontratë me shkrim me pronarin(ët) e stadiumit(eve) që do të shfrytëzojë.
- 32.03 Duhet të garantohet që stadiumi(et) mund të përdoret për ndeshjet e UEFA-së që luhen në shtëpi të aplikuesit për licencë gjatë sezonit të licencës.
- 32.04 Stadiumi(et) duhet të plotësojë kërkesat minimale të përcaktuara në *Rregulloren e UEFA-së për Infrastrukturën e Stadiumeve* dhe të klasifikohen të paktën si stadione të kategorisë 1 të UEFA-së.

Neni 33 Ambientet e trajnimeve – disponueshmëria

- 33.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë ambiente stërvitore në dispozicion gjatë gjithë vitit.
- 33.02 Nëse Aplikuesi për licencë nuk është pronar i ambienteve stërvitore, ai duhet të sigurojë kontratë me shkrim me pronarin(ët) e ambienteve stërvitore.
- 33.03 Duhet të garantohet që ambientet stërvitore mund të përdoren nga të gjitha ekipet e aplikuesit për licencë gjatë sezonit të licencës, duke marrë parasysh programin e vet zhvillimor të të rinjve.

Neni 34 Ambientet stërvitore – Infrastruktura minimale

- 34.01 Si minimum, infrastruktura e ambienteve stërvitore duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara nga licencuesi, për shembull:
- ambientet përkatëse të brendshme/të jashtme;
 - specifikat e këtyre ambienteve (d.m.th. numri dhe madhësia e fushave të futbollit);
 - specifikat e zhveshtoreve;
 - dhomën mjekësore dhe pajisjet minimale të saj (d.m.th. defibrilator dhe paketën e ndihmës së parë);
 - ndriçimi me projektorë;
 - çdo kërkesë tjetër përkatëse e identifikuar nga licencuesi.

Personeli dhe Kriteret Administrative

Neni 35 Zyrtari administrativ

- 35.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar një zyrtar administrativ i cili është përgjegjës për drejtimin e çështjeve të veta operative.

Neni 36 Zyrtari për media

- 36.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar një zyrtar të kualifikuar për media, i cili është përgjegjës për çështjet e medias, përfshirë promovimin e aktiviteteve të aplikuesit për licencë në mediat sociale.
- 36.02 Zyrtari për media duhet të ketë të paktën një nga kualifikimet e mëposhtme:
- Diplomë në gazetari;
 - Diplomë e zyrtarit për media, të lëshuar nga licencuesi ose nga një organizatë e pranuar nga licencuesi;
 - Pranimi/njohja e kompetencës e lëshuar nga licencuesi, bazuar në përvojën praktike prej të paktën tre vjetësh në çështje të tilla.

Neni 37 Mjeku

- 37.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar të paktën një mjek i cili është përgjegjës për mbështetjen mjekësore të skuadrës së parë të femrave gjatë ndeshjeve dhe stërvitjeve, si dhe për parandalimin e dopingut.
- 37.02 Kualifikimi i mjekut duhet të njihet/pranohet nga autoritetet përkatëse shëndetësore nacionale.
- 37.03 Mjeku duhet të jetë i regjistruar në mënyrë të duhur në federatën anëtare të UEFA-së ose në ligën e saj.

Neni 38 Fizioterapeuti

- 38.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar të paktën një fizioterapeut i cili është përgjegjës për trajtimin mjekësor dhe masazhet për skuadrën e parë të femrave gjatë stërvitjeve dhe ndeshjeve.
- 38.02 Kualifikimi i fizioterapeutit duhet të pranohet/njihet nga autoritetet përkatëse shëndetësore nacionale.
- 38.03 Fizioterapeuti duhet të jetë i regjistruar siç duhet në federatën anëtare të UEFA-së ose në ligën e lidhur me të.

Neni 39 Kryetrajneri i skuadrës së parë të femrave

- 39.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar një kryetrajner të kualifikuar të skuadrës së parë të femrave, i cili konfirmohet si trajner kryesor nga federata përkatëse anëtare e UEFA-së dhe që është përgjegjës për çështjet e mëposhtme të skuadrës së parë:
 - a. Përzgjedhjen e lojtareve;
 - b. Taktikën dhe stërvitjet;
 - c. Menaxhimin e lojtareve dhe stafit teknik në zhveshtore dhe në zonën teknike para, gjatë dhe pas ndeshjeve; dhe
 - d. Detyra në lidhje me çështjet e medias (konferenca për shtyp, intervista, etj.).
- 39.02 Kryetrajneri duhet të ketë një nga kualifikimet minimale të mëposhtme të trajnerit, të lëshuara nga një federatë anëtare e UEFA-së në përputhje me *Konventën e UEFA-së për Trajnerë*:
 - a. Licencë A të UEFA-së, e vlefshme për trajner;

- b. Pranim/Njohje e vlefshme nga UEFA për kompetencë, ekuivalente me licencën e kërkuar sipas pikës a) më lart.

Neni 40 Ndhmës-trajner i skuadrës së parë të femrave

- 40.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar një trajner të kualifikuar që ndihmon kryetrajnerin në të gjitha çështjet e futbollit të skuadrës së parë të femrave.
- 40.02 Ndhmës-trajneri i skuadrës së parë të femrave duhet të ketë një nga kualifikimet minimale të trajnerit si më poshtë, të lëshuara nga një federatë anëtare e UEFA-së në përputhje me *Konventën e UEFA-së për Trajnerë*:
 - a. Licenca e vlefshme B e trajnerit, e lëshuar nga UEFA;
 - b. Njohja e vlefshme e kompetencës, e lëshuar nga UEFA, ekuivalente me licencën e kërkuar sipas pikës a) më sipër.

Neni 41 Trajneri i portierëve të skuadrës së parë të femrave

- 41.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar një trajner të kualifikuar të portierëve i cili ndihmon kryetrajnerin në çështjet e portierëve të skuadrës së parë të femrave.
- 41.02 Trajneri i portierëve duhet të ketë një nga kualifikimet minimale të trajnerit si më poshtë, të lëshuar nga federata anëtare e UEFA-së.
 - a. Licencë B të vlefshme për portierë, e lëshuar nga UEFA në përputhje me *Konventën e UEFA-së për Trajnerë*;
 - b. Licencë të vlefshme vendore për portierë;
 - c. Njohje/pranim të vlefshëm të kompetencës të lëshuar nga UEFA në përputhje me *Konventën e UEFA-së për Trajnerë* dhe ekuivalente me licencën e kërkuar sipas pikës a) më sipër.

Neni 42 Trajnerët e ekipeve të të rinjve për femra

- 42.01 Aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar të paktën dy trajnerë të kualifikuar të cilët janë përgjegjës për të gjitha çështjet e futbollit që lidhen me ekipin(et) e të rinjve të femrave, siç përcaktohet në Nenin 20.
- 42.02 Të paktën një nga kryetrajnerët e të rinjve duhet të ketë një nga kualifikimet e mëposhtme minimale të trajnerit, të lëshuara nga një federatë anëtare e UEFA-së në përputhje me *Konventën e UEFA-s për Trajnerë*:
 - a. Licencë e vlefshme e UEFA-së për trajnerë për të rinjtë;

- b. Licencë B e vlefshme e UEFA-së për trajnerë;
- c. Pranimi/Njohja e vlefshme e kompetencës e lëshuar nga UEFA, e cila është ekuivalente me licencën e kërkuar sipas pikave a) ose b) më sipër, sipas rastit.

Neni 43 Dispozitat e zakonshme të UEFA-së të aplikueshme për kualifikime për trajnerë

- 43.01 Bartësi i licencës së kërkuar të trajnerit të UEFA-së sipas kuptimit të Nenit 39 deri në Nenin 42 konsiderohet trajner i cili, në përputhje me dispozitat e aplikueshme të *Konventës së UEFA-së për Trajnerë*:
 - a. i është lëshuar licencë e UEFA-së për trajnerë nga një federatë anëtare e UEFA-së; ose
 - b. të paktën të ketë filluar kursin për diplomë, të nevojshme për trajner të UEFA-së. Regjistrimi për kursin e nevojshëm për diplomë është i mjaftueshëm për të përmbushur këtë kriter.
- 43.02 Nëse statusi i anëtarësimit në *Konventën e UEFA-së për Trajnerë* të një federate anëtare të UEFA-së është ngritur/përmirësuar (p.sh. nga niveli A në Pro), zbatohen si më poshtë:
 - a. Në lidhje me paragrafin 1(a) më sipër, licenca e re më e lartë ose e dytë më e lartë e disponueshme e UEFA-së për trajnerë (siç është e aplikueshme), do të bëhet e detyrueshme për aplikuesin për licencë sapo licencuesi të ketë kryer kursin e tij të dytë në këtë nivel më të lartë. Pas kësaj periudhe kalimtare, vetëm një bartës i diplomës së trajnerit të UEFA-së të kërkuar rishtazi, do të konsiderohet se është në përputhje me kriterin;
 - b. Në lidhje me paragrafin 1(b) më sipër, vetëm pjesëmarrja në një kurs edukimi për diplomën e trajnerit më të lartë ose të dytë më të lartë të UEFA-së (sipas rastit), do të konsiderohet se është në përputhje me kriterin.
- 43.03 Në rast të një marrëveshjeje partneriteti sipas *Konventës së UEFA për Trajnerë*, aplikohen kualifikimet e UEFA-së për trajnerë të ofruara nga federata anëtare e UEFA-së me status të kufizuar anëtarësimi në *Konventën e UEFA-së për Trajnerë*.
- 43.04 UEFA rezervon të drejtën të rishikojë pasojat e çdo uljeje të statusit të anëtarësimit në *Konventën e UEFA-së për Trajnerë* (p.sh. nga niveli Pro në A) si dhe ato të marrëveshjeve të partneritetit me federatën në fjalë anëtare të UEFA-së, dhe të marrë vendimet rast pas rasti në këtë drejtim.
- 43.05 Të gjithë trajnerët e kualifikuar duhet të jenë të regjistruar siç duhet në federatën anëtare të UEFA-së dhe/ose ligën e saj.

Neni 44 Kontratat me shkrim

- 44.01 I gjithë personeli administrativ, teknik, mjekësor dhe i sigurisë ose ofruesit e shërbimeve që kryejnë ndonjë nga funksionet e përmendura në Nenin 35 deri në Nenin 42, duhet të kenë kontrata me shkrim me aplikuesin për licencë (ose një subjekt tjetër brenda strukturës së grupit ligjor të aplikuesit për licencë) në përputhje me kuadrin ligjor shtetëror.
- 44.02 Aplikuesi për licencë duhet të sigurojë që secila kontratë e trajnerëve të jetë në linjë me dispozitat përkatëse të *Rregullores së UEFA-së mbi Statusin dhe Transferin e Lojtarëve*.

Neni 45 Ofruesit e shërbimeve

- 45.01 Nëse një funksion i caktuar i besohet një ofruesi të shërbimeve në përputhje me kuadrin ligjor shtetëror, aplikuesi për licencë duhet të nënshkruajë kontratë me shkrim me ofruesin e shërbimeve. Ajo duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:
- a. Detyrat dhe përgjegjësitë e përkufizuara
 - b. Informacion lidhur me personin(at) përgjegjës për funksionin, duke përfshirë kualifikimet e tyre përkatëse.

Neni 46 Marrja e funksioneve

- 46.01 Funksionet e detyrueshme të përcaktuara në Nenin 35 deri në Nenin 42 përfaqësojnë strukturën minimale organizative që i kërkohet aplikuesit për licencë.
- 46.02 Një person mund të merr më shumë se një funksion, me kusht që personi të ketë kohë të mjaftueshme, kompetenca të përshtatshme dhe kualifikimet e nevojshme për secilin funksion dhe pa konflikt interesi.

Neni 47 Struktura organizative

- 47.01 Aplikuesi për licencë duhet t'i sigurojë licencuesit një skemë organizative që identifikon qartë personelin përkatës dhe përgjegjësitë e tyre hierarkike dhe funksionale në strukturën e tij organizative.
- 47.02 Minimalisht, skema organizative duhet të japë informacion mbi personelin kryesor të përcaktuar nga Neni 35 deri në Nenin 38.

Neni 38 Detyra e zëvendësimit gjatë sezonit

- 48.01 Nëse një funksion i përcaktuar në Nenin 35 deri në Nenin 42 mbetet vakant (i zbrazët) gjatë sezonit të licencës, i licencuari duhet të sigurojë që, brenda një periudhe maksimale prej 60 ditësh, funksionin e merr dikush që ka kualifikimin e duhur.
- 48.02 Në rast se një funksion mbetet vakant për shkak të sëmundjes ose aksidentit, licencuesi mund të miratojë një zgjatje të periudhës 60-ditore vetëm nëse është i bindur në mënyrë të arsyeshme se personi në fjalë është ende i paaftë nga pikëpamja mjekësore, për të rifilluar detyrat e tij.
- 48.03 I licencuari duhet të njoftojë menjëherë licencuesin për çdo zëvendësim të tillë.

Kriteret ligjore

Neni 49 Deklaratë në lidhje me pjesëmarrjen në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra

- 49.01 Aplikuesi për licencë duhet të dorëzojë një deklaratë ligjërisht të vlefshme që konfirmon si më poshtë:
- Ai njeh si ligjërisht të detyrueshme statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-së, UEFA-së, federatës anëtare të UEFA-së dhe, nëse ka, ligës nacionale, si dhe juridiksionin e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (GJAS) në Lozanë, siç parashihet në nenet përkatëse të *Statutit të UEFA-së*.
 - Në nivel shtetëror, do të luajë në gara të pranuar dhe të miratuara nga federata anëtare e UEFA-së (p.sh. kampionati nacional, kupa nacionale).
 - Në nivel ndërkombëtar, do të marrë pjesë në garat e pranuar nga UEFA (për të shmangur çdo dyshim. Kjo dispozitë nuk ka të bëjë me ndeshjet miqësore).
 - Ai do të informojë menjëherë licencuesin për çdo ndryshim të rëndësishëm, ngjarje ose gjendje me rëndësi të madhe ekonomike.
 - Ai do t'iu përmbahet dhe respektojë rregulloret e licencimit të klubit të licencuesit.
 - Ai do të përmbahet dhe do të respektojë *Rregulloren e UEFA-së për Licencimin e Klubeve për Ligën e Kampionëve të UEFA-së për Femra*.
 - Perimetri i raportimit të tij përcaktohet në përputhje me Nenin 55.
 - Të gjitha të ardhurat dhe kostot në lidhje me secilin prej aktiviteteve të futbollit të renditura në Paragrafin 55.03, të jenë përfshirë në perimetrin e raportimit.
 - Ai do të jetë përgjegjës për çdo pasojë që një subjekt i përfshirë në perimetrin e raportimit nuk i përmbahet dhe nuk respekton pikat e) dhe f) më sipër.

- j. Të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me çdo ndryshim të formës së tij ligjore, strukturës së grupit ligjor (përfshirë pronësinë) ose identitetin nga tre sezonet para fillimit të sezonit të licencave të jenë raportuar te licencuesi dhe UEFA.
- k. Të gjitha dokumentet e dorëzuara të jenë të plota dhe të sakta.
- l. Ai autorizon administratën nacionale kompetente të licencimit të klubeve dhe organet nacionale të licencimit të klubeve, administratën e UEFA-së dhe organet e UEFA-së për Administrimin e Drejtësisë, që të shqyrtojnë çdo dokument përkatës dhe të kërkojnë informacion nga çdo autoritet publik përkatës ose organ privat në përputhje me legjislacionin shtetëror.
- m. Ai pranon se UEFA rezervon të drejtën për të kryer auditime të pajtueshmërisë në përputhje me Nenin 63.

49.02 Deklarata duhet të ekzekutohet nga një nënshkrues i autorizuar i aplikuesit për licencë jo më shumë se tre muaj para afatit për dorëzimin e saj te licencuesi.

Neni 40 Informacioni minimal ligjor

50.01 Aplikuesi për licencë duhet të paraqesë të paktën informacionin minimal ligjor të mëposhtëm për aplikuesin për licencë dhe nëse është i ndryshëm, për anëtarin e regjistruar:

- a. Emrin e plotë ligjor;
- b. Formën juridike;
- c. Kopjen e statutit aktual, të vlefshëm (p.sh. aktin e kompanisë);
- d. Ekstrakt nga një regjistër publik (p.sh. regjistri tregtar);
- e. Listën e nënshkruesve të autorizuar;
- f. Llojin e nënshkrimit të kërkuar (p.sh. individual, kolektiv).

50.02 Aplikuesi për licencë duhet të sigurojë gjithashtu informacionin e kontaktit si më poshtë:

- a. Adresën e selisë zyrtare;
- b. Hollësitë zyrtare të kontaktit (si numrin e telefonit/faksit dhe adresat e emailit);
- c. Adresën e faqes (website) zyrtare publike;
- d. Emrin dhe detajet e kontaktit të drejtpërdrejtë të personit kryesor zyrtar të kontaktit për çështjet e licencimit të klubeve.

Neni 51 Kontratë me shkrim me një kompani futbollit

51.01 Nëse Aplikuesi për licencë është një kompani futbollit siç përcaktohet në Paragrafin 14.01(b), ai duhet të sigurojë një kontratë me shkrim të emërimit me një anëtar të regjistruar.

51.02 Kontrata duhet të përcaktojë së paku si vijon:

- a. Kompania e futbollit duhet të jetë në përputhje me statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet e zbatueshme të FIFA-së, UEFA-së, federatës anëtare të UEFA-së dhe ligës së saj.
- b. Kompania e futbollit nuk duhet të caktojë më tej të drejtën e saj për të marrë pjesë në një garë në nivel shtetëror ose ndërkombëtar.
- c. E drejta e kompanisë së futbollit për të marrë pjesë në një garë të tillë pushon së zbatuari nëse anëtarësimi i klubit caktues në federatë pushon.
- d. Nëse kompania e futbollit vihet në falimentim ose hyn në likuidim, kjo konsiderohet të jetë ndërprerje e anëtarësimit ose marrëdhënies kontraktuale sipas Nenit 14. Për hir të qartësisë, një licencë e dhënë tashmë për kompaninë e futbollit nuk mund të bartet/transferohet nga kompania e futbollit tek anëtari i regjistruar.
- e. Federatës anëtare të UEFA-së duhet t'i rezervohet e drejta për të miratuar emrin me të cilin kompania e futbollit merr pjesë në garat nacionale.
- f. Kompania e futbollit, me kërkesë të gjykatës kompetente nacionale të arbitrazhit ose Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (GJAS), duhet të sigurojë pikëpamje, informacione dhe dokumente për çështjet që lidhen me pjesëmarrjen e kompanisë së futbollit në garat nacionale ose ndërkombëtare.

51.03 Kontrata e emërimit dhe çdo ndryshim në të, duhet të miratohet nga federata anëtare e UEFA-së ose liga e saj.

Neni 52 Struktura e grupit ligjor

52.01 Aplikuesi për licencë duhet t'i sigurojë licencuesit një dokument që paraqet strukturën e grupit të tij ligjor në datën e referencës vjetore të kontabilitetit përpara afatit për dorëzimin e kërkesës për licencë te licencuesi.

52.02 Ky dokument duhet të identifikojë qartë dhe të përfshijë informacion mbi:

- a. aplikuesin për licencë dhe, nëse është i ndryshëm, anëtarin e regjistruar;
- b. çdo filial të aplikuesit për licencë dhe, nëse është i ndryshëm, anëtar të regjistruar;
- c. çdo subjekt të asociuar të aplikuesit për licencë dhe, nëse është i ndryshëm, anëtar të regjistruar;
- d. çdo palë që ka 10% ose më shumë pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të aplikuesit për licencë, ose 10% ose më shumë të drejta votimi;
- e. çdo subjekt kontrollues direkt ose indirekt të aplikuesit për licencë;
- f. çdo klub tjetër futbollit, në lidhje me të cilin ndonjë nga palët e identifikuar në a) deri në e), ose ndonjë nga personeli kryesor drejtues i tyre, ka ndonjë interes pronësie ose të drejtë vote, ose anëtarësim ose ndonjë përfshirje ose çfarëdo ndikim tjetër në menaxhim, administrim të tij ose performancë sportive; dhe

- g. personel drejtues kryesor të aplikuesit për licencë dhe, nëse është i ndryshëm, anëtar të regjistruar.

52.03 Perimetri raportues siç përcaktohet në Nenin 55 duhet gjithashtu të identifikohet qartë në dokument.

52.04 Informacioni i mëposhtëm duhet të jepet në lidhje me secilën nga palët e përfshira në strukturën e grupit ligjor:

- a. Emri dhe, nëse është e aplikueshme, forma ligjore;
- b. Aktiviteti kryesor; dhe
- c. Përqindja e interesit të pronësisë dhe, nëse është ndryshe, përqindja e të drejtave të votës. Për çdo filial të aplikuesit për licencë dhe, nëse është ndryshe, anëtari i regjistruar, duhet të jepet edhe informacioni i mëposhtëm:
- d. Kapitali aksionar;
- e. Totali i aseteve;
- f. Të hyrat totale; dhe
- g. Kapitali total.

52.05 Licencuesi duhet të informohet për çdo ndryshim që mund të ketë pasur në strukturën e grupit ligjor gjatë periudhës ndërmjet datës së referencës vjetore të kontabilitetit dhe dorëzimit të këtij informacioni te licencuesi.

52.06 Nëse konsiderohet e rëndësishme, licencuesi mund t'i kërkojë aplikuesit për licencë/të licencuarit të japë informacione të tjera përveç atyre të renditura më sipër.

52.07 Aplikuesi për licencë duhet të konfirmojë se informacioni për strukturën e grupit ligjor është i plotë, i saktë dhe në përputhje me këtë rregullore. Kjo duhet të dëshmohet me një deklaratë të shkurtër dhe nënshkrim nga organi ekzekutiv/nënshkruesit e autorizuar të aplikuesit për licencë.

Neni 53 Pala e fundit kontrolluese, përfituesi i fundit dhe pala me ndikim të rëndësishëm

53.01 Aplikuesi për licencë duhet t'i sigurojë licencuesit një dokument që përmban informacione për:

- a. palën e fundit kontrolluese të aplikuesit për licencë;
- b. përfituesin e fundit të aplikuesit për licencë, d.m.th. një person fizik në emër të të cilit zotërohet ose kontrollohet një subjekt ose marrëveshje, ose kryhet një transaksion; dhe
- c. çdo palë me ndikim të rëndësishëm mbi aplikuesin për licencë.

- 53.02 Informacioni i mëposhtëm duhet të jepet në lidhje me secilën nga palët e identifikuar në paragrafin 1 më sipër, në datën e dorëzimit të këtij informacioni te licencuesi:
- Emri dhe, nëse është e aplikueshme, forma ligjore;
 - Aktiviteti kryesor;
 - Përqindja e interesit të pronësisë dhe, nëse është ndryshe, përqindja e të drejtave të votës në lidhje me aplikuesin për licencë;
 - Nëse është e aplikueshme, personeli kryesor drejtues; dhe
 - Çdo klub tjetër futboll në lidhje me të cilin pala, ose ndonjë nga personeli kryesor drejtues i tij, ka ndonjë interes pronësie, të drejtë vote ose anëtarësimi ose çdo përfshirje ose ndikim tjetër.
- 53.03 Aplikuesi për licencë duhet të konfirmojë nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim në lidhje me informacionin e treguar në paragrafët 1 dhe 2 më sipër gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare vjetore deri në dorëzimin e informacionit te licencuesi.
- 53.04 Nëse ka ndodhur një ndryshim siç tregohet në paragrafin 3 më sipër, ai duhet të përshkruhet në detaje nga aplikuesi për licencë në informacionin për licencuesin. Si minimum duhet të jepet informacioni i mëposhtëm:
- Data në të cilën ka ndodhur ndryshimi;
 - Një përshkrim të qëllimit dhe arsyeve të ndryshimit;
 - Implikimet në politikat financiare, operative dhe sportive të aplikuesit për licencë; dhe
 - Një përshkrim të çdo ndikimi në kapitalin apo gjendjen e borxhit të aplikuesit për licencë.
- 53.05 Nëse konsiderohet e rëndësishme, licencuesi mund t'i kërkojë aplikuesit për licencë që t'i sigurojë informacion shtesë përveç atyre të renditura më sipër.
- 53.06 Aplikuesi për licencë duhet të konfirmojë që deklarata për palën e fundit kontrolluese, përfituesin e fundit dhe palën me ndikim të rëndësishëm është e plotë, e saktë dhe në përputhje me këtë rregullore. Kjo duhet të dëshmohet me anë të një deklaratë të shkurtër dhe të nënshkrimit nga organi ekzekutiv/nënshkruesit e autorizuar të aplikuesit për licencë dhe të palës së fundit kontrolluese të aplikuesit për licencë.

Neni 54 Përfaqësimi me shkrim para vendimit për licencim

- 54.01 Aplikuesi për licencë duhet të dorëzojë te licencuesi një përfaqësim me shkrim brenda shtatë ditëve para fillimit të procesit të vendimmarrjes të Organit të Shkallës së Parë, siç përcaktohet nga licencuesi në përputhje me Nenin 10.
- 54.02 Aplikuesi për licencë duhet të konfirmojë:

- a. që të gjitha dokumentet e dorëzuara te licencuesi janë të plota, të sakta dhe në përputhje me këtë rregullore;
- b. nëse ka ndodhur apo jo ndonjë ndryshim domethënës apo ngjarje e ngjashme në lidhje me kërkesën e tij për licencim ose ndonjë nga kriteret e licencimit të klubeve;
- c. nëse ka ndodhur apo jo ndonjë ngjarje ose gjendje me rëndësi të madhe ekonomike që mund të ketë ndikim negativ në pozicionin financiar të aplikuesit për licencë që nga data e bilancit të auditimit të pasqyrave financiare vjetore të mëparshme dhe pasqyrat e rishikuara financiare të përkohshme (nëse po, letra e përfaqësimit të menaxhmentit duhet të përfshijë një përshkrim të natyrës së ngjarjes ose gjendjes dhe një vlerësim të efektit financiar të saj, ose një deklaratë se një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet);
- d. nëse aplikuesi për licencë, nëse është i ndryshëm, anëtar i regjistruar ose ndonjë kompani mëmë e aplikuesit për licencë të përfshirë në perimetrin e raportimit, është duke kërkuar ose ka pranuar mbrojtje nga kreditorët e vet në përputhje me ligjet ose rregulloret brenda 12 muajve para sezonit të licencës.

54.03 Miratimi nga menaxhmenti i aplikuesit për licencë duhet të dëshmohet me anë të një nënshkrimit në emër të organit ekzekutiv të aplikuesit për licencë.

Kriteret financiare

Neni 55 Subjekti/subjektet raportuese dhe perimetri raportues

55.01 Aplikuesi për licencë përcakton dhe i jep licencuesit perimetrin e raportimit, d.m.th. subjektin ose kombinimin e subjekteve në lidhje me të cilat duhet të jepet informacioni financiar (p.sh. një subjekt i vetëm, pasqyra financiare të konsoliduara ose të kombinuara).

55.02 Perimetri raportues duhet të përfshijë:

- a. aplikuesin për licencë dhe, nëse është i ndryshëm, anëtarin e regjistruar;
- b. çdo filial të aplikuesit për licencë dhe, nëse është i ndryshëm, anëtarin e regjistruar;
- c. çdo subjekt, pavarësisht nëse është i përfshirë ose jo në strukturën e grupit ligjor, i cili gjeneron të ardhura dhe/ose kryen shërbime dhe/ose mbart kosto sa i përket ndonjërit prej aktiviteteve të futbollit të femrave, të përcaktuara në paragrafin 3 (a) dhe (b) më poshtë;
- d. çdo subjekt tjetër të përfshirë në strukturën e grupit ligjor i cili gjeneron të ardhura dhe/ose kryen shërbime dhe/ose mbart kosto në lidhje me ndonjë nga aktivitetet e futbollit të femrave, të përcaktuara në paragrafin 3 (c) deri (j) më poshtë.

55.03 Aktivitetet e futbollit të femrave përfshijnë:

- a. punësimin/rekrutimin e punonjësve (siç përcaktohet në Nenin 58) duke përfshirë pagesën e të gjitha formave të shumës për punonjësit që rrjedhin nga detyrimet kontraktuale ose ligjore;
- b. blerjen/shitjen e regjistrimeve të lojtarëve (përfshirë huazimet);
- c. biletat;
- d. sponsorizimin dhe reklamimin;
- e. transmetimin;
- f. tregtimin dhe mikpritjen;
- g. operimet e klubit (administrimi, aktivitetet e ditës së ndeshjes, udhëtimet, skautizmi, etj.);
- h. përdorimin dhe menaxhimin e stadiumeve dhe ambienteve stërvitore;
- i. zhvillimin e të rinjve; dhe
- j. financimin, duke përfshirë kapitalin që rezulton në detyrime ndaj aplikuesit për licencë, ose borxhe të siguruara ose të zotuar direkt ose indirekt kundrejt aseteve ose të hyrave të aplikuesit për licencë.

55.04 Një subjekt mund të përjashtohet nga perimetri raportues vetëm nëse:

- a. aktivitetet e futbollit që ai kryen janë tashmë tërësisht të pasqyruara në pasqyrat financiare të njërit prej subjekteve të përfshira në perimetrin e raportimit; dhe
- b. aktivitetet e tij janë krejtësisht të pa ndërlidhura me aktivitetet e futbollit, të përcaktuara në paragrafin 3 më sipër, ose vendndodhjet, asetet ose markën e klubit të futbollit; ose
- c. është i parëndësishëm krahasuar me të gjitha subjektet që formojnë perimetrin e raportimit dhe nuk kryen asnjë nga aktivitetet e futbollit të përcaktuara në paragrafin 3 (a) dhe (b) më sipër.

55.05 Aplikuesi për licencë duhet të dorëzojë një deklaratë nga një nënshkrues i autorizuar, me të cilën konfirmon:

- a. se të gjitha të hyrat dhe kostot që lidhen me secilin nga aktivitetet e futbollit të treguara në paragrafin 3, janë përfshirë në perimetrin e raportimit, duke ofruar shpjegim të detajuar nëse nuk është kështu; dhe
- b. nëse ndonjë subjekt i përfshirë në strukturën e grupit ligjor është përjashtuar nga perimetri i raportimit, duke justifikuar ndonjë përjashtim të tillë, duke iu referuar paragrafit 4.

Neni 56 Pasqyrat financiare vjetore

56.01 Aplikuesi për licencë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në UEFA, deri në datën e komunikuar nga licencuesi, pasqyrat financiare vjetore për periudhën raportuese që përfundon në vitin para afatit për dorëzimin e aplikimit të licencuesi dhe para afatit për dorëzimin e listës së vendimeve të licencimit.

- 56.02 Pasqyrat financiare vjetore, përfshirë shumat krahasuese për periudhën paraprake, duhet të përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ose standardet nacionale të kontabilitetit (siç është e aplikueshme) dhe duhet të përfshijnë:
- një bilanc në fund të periudhës raportuese;
 - një llogari fitimi dhe humbje/pasqyra e të hyrave për periudhën raportuese;
 - pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme për periudhën raportuese;
 - një pasqyrë të ndryshimeve në kapital gjatë periudhës raportuese;
 - shënime, që përmbajnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese; dhe
 - një rishikim financiar nga menaxhmenti.
- 56.03 Pasqyrat financiare vjetore duhet të auditohen nga një auditor i pavarur në pajtim me kuadrin ligjor shtetëror.
- 56.04 Nëse pasqyrat financiare vjetore nuk plotësojnë kërkesat minimale për dhënien e informacioneve shpjeguese të përcaktuara në Aneksin E, atëherë aplikuesi për licencë duhet t'i dorëzojë licencuesit edhe:
- informacion shtesë për të përmbushur kërkesat minimale të zbulimit të informacionit, të përcaktuara në Aneksin E; dhe
 - një raport vlerësimi të ofruar nga i njëjti auditor që nënshkruan pasqyrat financiare vjetore me anë të procedurave të dakorduara, të përshkruara nga licencuesi, për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e informacionit shtesë.
- 56.05 Kur skuadrat dhe aktivitetet e futbollit të femrave janë pjesë e të njëjtit person juridik/perimetër raportues si ekipet dhe aktivitetet e futbollit të meshkujve, aplikuesi për licencë duhet të identifikojë të hyrat dhe shpenzimet që lidhen me aktivitetet e futbollit të femrave dhe të përgatisë një llogari të fitimit dhe humbjes në përputhje me kërkesat e Aneksit E.

Neni 57 Asnjë detyrim i vonuar për klubet e futbollit

- 57.01 Aplikuesi për licencë duhet të vërtetojë se më datën 31 mars para sezonit të licencës, nuk ka detyrime të prapambetura (siç përcaktohet në Aneksin F) ndaj klubeve të tjera të futbollit si rezultat i detyrimeve që rrjedhin nga transferet që duhen paguar deri më 28 shkurt para sezonit të licencës.
- 57.02 Detyrime të prapambetura janë ato shuma që i detyrohen klubeve të futbollit si rezultat i:
- transfereve të lojtarëve profesionistë (siç përcaktohet në *Rregulloren e FIFA-së për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve*), duke përfshirë çdo shumë të pagesave me përmbushjen e kushteve të caktuara;

- b. lojtarëve të regjistruar për herë të parë si profesionistë, duke përfshirë çdo shumë të papaguar me plotësimin e kushteve të caktuara;
- c. kompensimin e trajnimit dhe kontributet e solidaritetit siç përcaktohet në *Rregulloren e FIFA-së mbi Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve*; dhe
- d. çdo përgjegjësie solidare e vendosur nga një autoritet kompetent për ndërprerjen e një kontrate nga ana e një lojtari.

57.03 Aplikuesi për licencë duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë licencuesit një tabelë transferimesh, përveç rasteve kur informacioni i transferimeve i është zbuluar tashmë licencuesit sipas kushteve ekzistuese nacionale të transferimeve (p.sh. sistemi shtetëror i kliringut) dhe licencuesi është në gjendje të nxjerrë dhe vlerësojë të gjithë informacionin e kërkuar siç është përshkruar në paragrafët 4 dhe 5 më poshtë. Duhet të përgatitet një tabelë e transferimeve edhe në qoftë se nuk ka pasur transferime/huazime gjatë periudhës përkatëse.

57.04 Aplikuesi për licencë duhet të ofrojë:

- a. të gjitha regjistrimet e lojtarëve të rinj (përfshirë huazimet) si rezultat i marrëveshjeve të transferimeve të lidhura në periudhën 12-mujore deri më 28 shkurt, pavarësisht nëse ka një shumë të papaguar më 28 shkurt;
- b. të gjitha transferimet për të cilat një pagesë është e papaguar deri më 28 shkurt (qoftë nëse ato kanë të bëjnë me lirim apo regjistrimin e lojtarëve dhe pavarësisht se kur janë kryer transferimet); dhe
- c. të gjitha transferimet që i nënshtrohen çdo shume të kontestuar deri më 28 shkurt.

57.05 Tabela e transferimeve duhet të përmbajë informatat e mëposhtme si një minimum (lidhur me çdo transferim të lojtarëve)

- a. Emrin e lojtarit dhe datën e lindjes;
- b. Datën e marrëveshjes së transferimit;
- c. Emrin e klubit të futbollit që është kreditor;
- d. Tarifën e transferimit (ose të huazimit) të paguar ose të papaguar (përfshirë kompensimin e stërvitjeve dhe kontributin e solidaritetit) edhe nëse shuma e papaguar nuk është kërkuar nga kreditori;
- e. Kostot e tjera direkte të regjistrimit të lojtarëve të paguara ose të papaguara;
- f. Çdo kompensim tjetër i paguar ose i papaguar në kuadër të një marrëveshjeje transferimi;
- g. Shumat e shlyera para datës 28 shkurt dhe data(t) e pagesës;
- h. Gjendja e pagesave deri më 28 shkurt, duke përfshirë datën(at) e skadimit për çdo element të papaguar;
- i. Shumat e vonuara deri më 28 shkurt, duke përfshirë datën(at) e skadimit për çdo element të papaguar dhe, nëse është e aplikueshme, shumat e shlyera ndërmjet datës 28 shkurt dhe datës 31 mars, së bashku me datat e shlyerjes, si dhe çdo vonesë të mbetur të pagesave deri më 31 mars (të bartura nga 28 shkurt), së bashku me komentimin shpjegues;

- j. Shumat e shtyra deri më 28 shkurt (siç përkufizohet në Aneksin F), duke përfshirë datën(at) origjinale dhe të reja për çdo element të shtyrë, dhe datën kur është lidhur një marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve;
- k. Shumat e kontestuara deri më 28 shkurt (siç përcaktohet në Aneksin F), duke përfshirë referencat e rastit dhe një përshkrim të shkurtër të qëndrimeve të të gjitha palëve të përfshira; dhe
- l. Shumat e kushtëzuara (detyrimet e paparapara) që nuk janë pranuar ende në bilanc deri më 28 shkurt.

57.05 Aplikuesi për licencë duhet të barazojë detyrimet e tij sipas tabelës së transferimeve me të dhënat e tij themelore të kontabilitetit.

57.06 Aplikuesi për licencë duhet të vërtetojë se tabela e transferimeve është e plotë, e saktë dhe në përputhje me këtë rregullore. Kjo duhet të dëshmohet me anë të një deklaratë të shkurtër dhe me një nënshkrim nga organi ekzekutiv/nënshkruesit e autorizuar të aplikuesit për licencë.

Neni 58 Asnjë detyrim i prapambetur në lidhje me punonjësit

58.01 Aplikuesi për licencë duhet të vërtetojë se deri më datën 31 mars para sezonit të licencës, nuk ka detyrime të prapambetura (siç përcaktohet në Aneksin F) në lidhje me punonjësit e tij, si rezultat i detyrimeve kontraktuale ose ligjore që duhen paguar deri më 28 Shkurt, para sezonit të licencës.

58.02 Detyrimet e prapambetura janë të gjitha format e shumës që duhen paguar në lidhje me punonjësit, si rezultat i detyrimeve kontraktuale ose ligjore, duke përfshirë pagat, mëditjet, pagesat e të drejtave të imazhit, shpërblimet dhe përfitimet e tjera.

58.03 Termi "punonjës" përfshin personat e mëposhtëm:

- a. Të gjithë lojtarët profesionistë sipas *Rregullores së FIFA-së për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve*;
- b. Të gjithë personelin administrativ, teknik, mjekësor dhe të sigurisë që kryen ndonjë nga funksionet e përmendura në Nenin 35 deri në Nenin 42; dhe
- c. Ofruesit e shërbimeve që kryejnë ndonjë nga funksionet e përmendura në Nenin 35 deri në Nenin 42.

58.04 Nëse ndonjë nga "punonjësit" është i punësuar, i kontraktuar, konsulent ose i ofron shërbime një subjekti brenda strukturës së grupit ligjor ose perimetrit të raportimit, përveç aplikuesit për licencë, këto detyrime duhet të përfshihen gjithashtu në sferën e paragrafit 1 më sipër.

- 58.05 Shumat e papaguara për personat që, për arsye të ndryshme, nuk janë më të punësuar ose të angazhuar nga aplikuesi për licencë ose një subjekt brenda strukturës së grupit ligjor të aplikuesit për licencë, përfshihen në sferën e këtij kriteri dhe duhet të shlyhen brenda periudhës së përcaktuar në kontratë ose të përcaktuar me ligj, pavarësisht se si këto detyrime llogariten në pasqyrat financiare.
- 58.06 Aplikuesi për licencë duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë licencuesit një tabelë të punonjësve që tregon bilancet totale të mëposhtme në lidhje me punonjësit deri më datën 28 shkurt, para sezonit të licencës:
- Gjendja totale e detyrimeve;
 - Shuma totale e vonuar si dhe çdo shumë e mbetur e vonuar deri më 31 mars (e bartur nga 28 shkurti);
 - Shuma totale e shtyrë (siç përcaktohet në Aneksin F); dhe
 - Shuma totale e kontestuar (siç përcaktohet në Aneksin F).
- 58.07 Informacioni i mëposhtëm duhet të jepet, së paku, në lidhje me çdo shumë të vonuar, të shtyrë ose të kontestuar deri më 28 shkurt, së bashku me një koment shpjegues:
- Emri dhe pozicioni/funksioni i punonjësit (pavarësisht nëse personi ka qenë i punësuar apo i angazhuar gjatë vitit deri më 28 shkurt);
 - Data e fillimit dhe data e përfundimit (nëse është e aplikueshme);
 - Shumat e vonuara, duke përfshirë datën(at) e skadimit për çdo element të papaguar dhe, nëse është e aplikueshme, shumat e shlyera ndërmjet 28 shkurtit dhe 31 marsit, së bashku me datat e shlyerjes, si dhe çdo vonesë të mbetur të detyrimeve deri më 31 mars (të bartura nga 28 shkurti) ;
 - Shumat e shtyra, duke përfshirë datën(at) origjinale dhe të reja të skadimit për secilin element të shtyrë dhe datën kur është arritur një marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve; dhe
 - Shumat e kontestuara, duke përfshirë referencat e rastit dhe një përshkrim të shkurtër të qëndrimeve të të gjitha palëve të përfshira.
- 58.08 Aplikuesi për licencë duhet të bëjë barazimin e detyrimeve të tij sipas tabelës së punonjësve me të dhënat e tij themelore të kontabilitetit.
- 58.09 Aplikuesi për licencë duhet të konfirmojë që tabela e punonjësve është e plotë, e saktë dhe në përputhje me këtë rregullorë. Kjo duhet të dëshmohet me një deklaratë të shkurtër dhe nënshkrim nga organi ekzekutiv/nënshkruesit e autorizuar të aplikuesit për licencë.

Neni 59 Asnjë detyrim të prapambetur ndaj autoriteteve shoqërore/tatimore

- 59.01 Aplikuesi për licencë duhet të vërtetojë se në datën 31 mars para sezonit të licencës, ai nuk ka detyrime të prapambetura (siç përcaktohet në Aneksin F) ndaj autoriteteve shoqërore/tatimore si rezultat i detyrimeve kontraktuale ose ligjore në lidhje me të gjithë individët e punësuar për t'u paguar deri më 28 shkurt, para sezonit të licencës.
- 59.02 Detyrimet e prapambetura janë ato shuma që i detyrohen autoriteteve shoqërore/tatimore si rezultat i detyrimeve kontraktuale ose ligjore në lidhje me të gjithë individët e punësuar. Detyrimet e prapambetura përfshijnë, por nuk kufizohen në, tatimin mbi të ardhurat personale, pagesat e fondeve pensionale, sigurimet shoqërore dhe pagesa të ngjashme.
- 59.03 Aplikuesi për licencë duhet t'i dorëzojë licencuesit një tabelë shoqërore/tatimore në datën 28 shkurt, para sezonit të licencës, duke treguar:
- bilancin total të pagesave ndaj autoriteteve shoqërore/tatimore;
 - shumën totale të vonuar si dhe çdo shumë të mbetur të vonuar më 31 mars (të bartura nga 28 shkurti);
 - shumën totale të shtyrë (siç përcaktohet në Aneksin F);
 - shumën totale të kontestuar (siç përcaktohet në Aneksin F); dhe
 - shumën totale që i nënshtrohet një vendimi në pritje nga autoriteti kompetent (siç përcaktohet në Aneksin F).
- 59.04 Informacioni i mëposhtëm duhet të jepet, të paktën, në lidhje me çdo shumë të vonuar, të shtyrë, të kontestuar ose në pritje më 28 shkurt, së bashku me komentet shpjeguese:
- Emri i kreditorit;
 - Shumat e vonuara, duke përfshirë datën(at) e skadimit për çdo element të papaguar dhe, nëse është e aplikueshme, shumat e shlyera ndërmjet 28 shkurtit dhe 31 marsit, së bashku me datat e shlyerjes, si dhe çdo vonesë të mbetur të pagesave deri më 31 mars (të bartura nga 28 shkurti);
 - Shumat e shtyra, duke përfshirë datën(at) origjinale dhe të reja të skadimit për secilin element të shtyrë dhe datën kur është arritur një marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve;
 - Shumat që i nënshtrohen një vendimi në pritje nga autoriteti kompetent dhe një përshkrim të shkurtër të kërkesës së aplikuesit për licencë; dhe
 - Shumat e kontestuara, duke përfshirë referencat e rastit dhe një përshkrim të shkurtër të qëndrimeve të të gjitha palëve të përfshira.
- 59.05 Aplikuesi për licencë duhet të barazojë detyrimet e tij sipas tabelës sociale/tatimore me të dhënat e tij themelore të kontabilitetit.

59.06 Aplikuesi për licencë duhet të konfirmojë që tabela sociale/tatimore është e plotë, e saktë dhe në përputhje me këtë rregullore. Kjo duhet të dëshmohet me një deklaratë të shkurtër dhe nënshkrim nga organi ekzekutiv/nënshkruesit e autorizuar të aplikuesit për licencë.

Neni 60 Asnjë detyrim i vonuar në lidhje me UEFA-në dhe licencuesin

60.01 Aplikuesi për licencë duhet të dëshmojë se më datën 31 mars para sezonit të licencës, ai nuk ka detyrime të prapambetura (siç përcaktohet në Aneksin F) në lidhje me UEFA-në, subjektet shtesë të përcaktuara nga UEFA ose licencuesi, si rezultat i detyrimeve që duhen paguar deri më 28 shkurt, para sezonit të licencës.

60.02 Detyrimet e prapambetura në lidhje me UEFA-në përfshijnë, por nuk kufizohen në, masat disiplinore financiare të vendosura nga OUKFK.

60.03 Brenda afatit dhe në formën e komunikuar nga licencuesi, aplikuesi për licencë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë një deklaratë që konfirmon totalin e detyrimeve ndaj UEFA-së, subjekteve shtesë të përcaktuara nga UEFA dhe licencuesit, dhe mungesën ose ekzistencën e pagesave të vonuara.

III Dispozitat përfundimtare

Neni 61 Teksti autoritativ dhe gjuha e korrespondencës

- 61.01 Nëse ka ndonjë mospërputhje në interpretimin e versioneve në anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe rusisht të kësaj rregulloreje, mbizotëron versioni anglisht.
- 61.02 E gjithë korrespondenca ndërmjet UEFA-së dhe licencuesit dhe/ose të licencuarit duhet të jetë në një nga tre gjuhët zyrtare të UEFA-së (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht) dhe UEFA mund t'i kërkojë licencuesit dhe/ose të licencuarit përkthim të vërtetuar të dokumenteve me shpenzimet e tyre.

Neni 62 Anekset

- 62.01 Të gjitha Anekset në këtë rregullore janë pjesë integrale të saj.

Neni 63 Auditimet e përputhshmërisë

- 63.01 UEFA dhe/ose organet/agjencitë e saj të emëruara rezervojnë të drejtën që, në çdo kohë, të kryejnë auditime të pajtueshmërisë të licencuesit dhe të aplikuesit për licencë/të licencuarit.
- 63.02 Auditimet e përputhshmërisë synojnë të sigurojnë që licencuesi dhe aplikuesi për licencë/i licencuari të kenë përmbushur detyrimet e tyre siç përcaktohet në këtë rregullore dhe se licenca të jetë dhënë në mënyrë korrekte, në kohën kur licencuesi ka marrë vendimin e formës së prerë.
- 63.03 Për qëllime të auditimit të përputhshmërisë, në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretimin e rregulloreve nacionale të licencimit të klubeve midis një versioni në gjuhën zyrtare të UEFA-së dhe versionit të gjuhës zyrtare nacionale, mbizotëron versioni i gjuhës zyrtare të UEFA-së.

Neni 64 Procedurat disiplinore

- 64.01 OUKFK gjatë gjithë kohës ka parasysh objektivat e përgjithshme të kësaj rregulloreje, në veçanti për të mposhtur çdo përpjekje për t'i anashkaluar ato objektiva.
- 64.02 Çdo shkelje e kësaj rregulloreje mund të trajtohet nga UEFA në përputhje me këtë rregullore dhe *Rregullat procedurale që rregullojnë Organin e UEFA-së për Kontrollin Financiar të Klubeve (OUKFK)*.

Neni 65 Dispozitat zbatuese

65.01 UEFA do të marrë vendimet dhe do t'i miratojë, në formën e direktivave, dispozitat e detajuara të nevojshme për zbatimin e kësaj rregullore.

Neni 66 Miratimi, shfuqizimi dhe hyrja në fuqi

66.01 Kjo rregullore u miratua nga Komiteti Ekzekutiv i UEFA-së në mbledhjen e tij të datës 10 maj 2022.

66.02 Kjo rregullore zëvendëson *Rregulloren e UEFA-së për Licencimin e Klubeve dhe Rregulloren e Fair Play Financiar (Edicioni 2018)*.

66.03 Kjo rregullore hyn në fuqi më datën 1 qershor 2022, me dispozitat e jashtëzakonshme dhe kalimtare të përshkruara në nenin 67.

Neni 67 Dispozitat e jashtëzakonshme dhe kalimtare

67.01 Pavarësisht nga paragrafi 66.03 më lart, nenet 40 dhe 41 hyjnë në fuqi më datën 1 qershor 2023.

67.02 Me përjashtim të nenit 14, paragrafët 14.02, 14.04 dhe 14.05 hyjnë në fuqi më datën 1 qershor 2024.

67.03 Me përjashtim të Nenit 20, për sezonin e licencës 2023/24, aplikuesi për licencë duhet të ketë së paku një ekip të të rinjve të moshave nga 12 deri në 21 vjeç.

67.04 Me përjashtim të Nenit 42, për sezonin e licencës 2023/24, aplikuesi për licencë duhet të ketë të emëruar të paktën një trajner të kualifikuar me kualifikimin minimal të trajnerit, siç përcaktohet nga federata anëtare e UEFA-së.

67.05 Me përjashtim të Nenit 56, paragrafët 56.02(c), 56.04 dhe 56.05 hyjnë në fuqi më datën 1 qershor 2023.

67.06 Me përjashtim të Nenit 56, paragrafi 56.03 hyn në fuqi më datën 1 qershor 2025.

67.07 Pavarësisht paragrafit 67.06 më sipër, për paraqitësit e kërkesave për licencë që marrin pjesë në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve të UEFA-së për femra 2024/25, Paragrafi 56.03 hyn në fuqi më datën 1 qershor 2024.

Aneksi A Politika e përjashtimeve

A.1 Parimet

A.1.1 Administrata e UEFA-së ose OUKFK, në përputhje me Nenin 13, mund të bëjë përjashtime për çështjet e mëposhtme:

- a. Mos-zbatueshmërinë e një kërkesë minimale në lidhje me organet vendimmarrëse ose procesin e përcaktuar në Nenin 7 për shkak të ligjit shtetëror ose për ndonjë arsye tjetër;
- b. Mos-zbatueshmërinë e një kërkesë minimale në lidhje me procesin thelbësor të përcaktuar në Nenin 10 për shkak të ligjit shtetëror ose për ndonjë arsye tjetër;
- c. Mos-zbatueshmërinë e një procedure minimale të vlerësimit, të përcaktuar në Nenin 11 për shkak të ligjit shtetëror ose për ndonjë arsye tjetër;
- d. Mos-zbatueshmërinë e rregullit tre-vjeçar, të përcaktuar në Nenin 14;
- e. Mos-zbatueshmërinë e një kriteri të caktuar, të përcaktuar në pjesën II, Kapitulli 3: dhe Aneksëve përkatëse për shkak të legjislacionit shtetëror ose për ndonjë arsye tjetër;
- f. Zgjatja e periudhës së hyrjes për zbatimin e një kriteri ose një kategorie kriteri të përcaktuar në pjesën II, Kapitulli 3.

A.1.2 Përjashtimet lidhur me paragrafët a), b), c), e) dhe f) i bëhen një federate anëtare të UEFA-së dhe zbatohen për të gjitha klubet që janë të regjistruara në federatën anëtare të UEFA-së dhe paraqesin kërkesë për licencë për të hyrë në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra.

A.1.3 Përjashtimet lidhur me pikën d) bëhen për një klub të vetëm i cili paraqet kërkesë për licencë.

A.2 Procesi

A.2.1 Administrata e UEFA-së ose OUKFK veprojnë si organe vendim-marrëse për kërkesat për të bërë përjashtime. UEFA vendos për të gjitha përjashtimet që ndërlidhen me Aneksin A.1.1 (a), (b), (c), (e) dhe (f), dhe OUKFK vendos për kërkesat për përjashtime që ndërlidhen me Aneksin A.1.1 (d).

A.2.2 Kërkesa për përjashtim duhet të bëhet me shkrim, në mënyrë të qartë dhe të bazuar mirë.

A.2.3 Kërkesat për përjashtim në lidhje me Aneksin A.1.1(a), (b), (c), (e) dhe (f) duhet të dorëzohen nga licencuesi brenda afatit të fundit dhe në formën e komunikuar nga UEFA.

A.2.4 Kërkesat për përjashtim në lidhje me Aneksin A.1.1(d) duhet të dorëzohen nga licencuesi në emër të aplikuesit për licencë brenda afatit dhe në formën e komunikuar nga UEFA.

Është përgjegjësi e aplikuesit për licencë/të licencuarit të sigurojë që kërkesa të jetë e plotë dhe e saktë.

A.2.5 Administrata e UEFA-së dhe OUKFK përdorin diskrecionin (lirinë) e nevojshëm për të bërë përjashtime brenda kufijve të kësaj rregulloreje.

A.2.6 Statusi dhe gjendja e futbollit dhe e aplikuesit për licencë brenda territorit të federatës anëtare të UEFA-së merret në konsideratë kur merret parasysh një përjashtim. Kjo përfshin, për shembull:

- a. madhësinë e territorit, popullsinë, gjeografinë, prejardhjen ekonomike;
- b. madhësinë e federatës anëtare të UEFA-së (numrin e klubeve, numrin e lojtarëve dhe ekipeve të regjistruara, madhësinë dhe cilësinë e administrimit të federatës, etj.);
- c. nivelin e futbollit (klubet profesionale, gjysmë-profesionale ose amatore);
- d. statusin e futbollit si sport brenda territorit dhe potencialin e tij në treg (frekuentimi mesatar, tregu televiziv, sponsorizimi, potenciali i të hyrave, etj.);
- e. koeficientin e UEFA-së (shoqatat dhe klubet e saj) dhe renditjen sipas FIFA-së;
- f. situatën e pronësisë së stadiumit (klubi, qyteti/komuniteti, etj.) brenda federatës;
- g. mbështetjen (financiare dhe të tjera) nga autoritetet qendrore, rajonale dhe lokale, duke përfshirë ministrinë e sportit;
- h. mbrojtjen e kreditorëve;
- i. strukturën e grupit ligjor të klubit dhe perimetrit e raportimit;
- j. identitetin e klubit.

A.2.7 Një vendim në lidhje me Aneksin A.1.1 (a), (b), (c), (e) dhe (f) i komunikohet me shkrim licencuesit, duke paraqitur arsyetimin. Më pas, licencuesi duhet t'ia komunikojë atë të gjithë paraqitësve të interesuar të kërkesave për licencë.

A.2.8 Një vendim në lidhje me Aneksin A.1.1(d) i komunikohet me shkrim licencuesit dhe klubit kërkuar, duke paraqitur arsyetimin.

A.2.9 Kundër vendimeve formës së prerë të marra nga administrata e UEFA-s ose OUKFK mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (GJAS) në përputhje me dispozitat përkatëse të përcaktuara në Statutin e UEFA-së.

Aneksi B Delegimi i përgjegjësive të licencimit tek një ligë e ndërlidhur

B.1 Parimet

- B.1.1** Komiteti Ekzekutiv i UEFA-së vendos për çdo kërkesë të adresuar nga federatat anëtare të UEFA-së për të deleguar ose për të tërhequr përgjegjësitë e licencimit në/nga liga e tyre e ndërlidhur siç specifikohet në Paragrafin 5.02.
- B.1.2** Kërkesat e bazuara mirë mund t'i adresohen UEFA-së në çdo kohë. Të gjitha kërkesat me shkrim të paraqitura në UEFA para fillimit të procesit bazë, konsiderohen për efekt në sezonin e ardhshëm sportiv.
- B.1.3** Koha e një kërkesë të tillë duhet të konsiderohet me kujdes. UEFA nuk pranon asnjë kërkesë për të deleguar ose për të tërhequr përgjegjësitë e licencimit gjatë procesit bazë, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia.
- B.1.4** Komiteti Ekzekutiv i UEFA-së mund të miratojë një kërkesë delegimi nëse federata anëtare e UEFA-së jep konfirmim me shkrim se liga:
- a. është e lidhur me federatën anëtare të UEFA-së dhe se me shkrim ka pranuar statutin dhe rregulloret e saj dhe vendimet e organeve përgjegjëse dhe kompetente;
 - b. është përgjegjëse për drejtimin e kampionatit më të lartë vendor;
 - c. ka rënë dakord me federatën anëtare të UEFA-së për shfrytëzimin e kontributeve financiare të paguara nga UEFA për federatën anëtare të UEFA-së për qëllime të licencimit të klubeve;
 - d. ka dorëzuar një vendim me shkrim nga organi legjislativ i kësaj lige për të përmbushur detyrimet e mëposhtme ndaj UEFA-së:
 - i. të ketë rregullore nacionale për licencimin e klubeve që zbatojnë kriteret e UEFA-së për licencimin e klubeve sipas dispozitave të këtyre rregulloreve dhe çdo ndryshimi në të ardhmen;
 - ii. t'i japë UEFA-së dhe organeve/agjencive të saj të emëruara, të gjithë qasjen e nevojshme për të verifikuar funksionimin e sistemit të licencimit të klubeve dhe vendimet e organeve vendimmarrëse në çdo kohë;
 - iii. të lejojë UEFA-në dhe organet/agjencitë e saj të emëruara të kryejnë auditime të pajtueshmërisë në çdo kohë, të klubeve që kualifikohen për Ligën e Kampionëve të UEFA-së për Femra;
 - iv. të pranojë çdo vendim të UEFA-së të marrë në lidhje me përjashtimet ose auditimet e pajtueshmërisë;
 - iv. të lëshojë sanksionet e duhura për palët përkatëse sipas rekomandimeve ose vendimeve të UEFA-së.

Aneksi C Integrimi i kriterëve të licencimit të klubeve të Ligës së Kampionëve të UEFA-së për femra në rregulloren nacionale të licencimit të klubeve

C.1 Parimet

C.1.1 Në rregulloret e tij nacionale për licencimin e klubeve, çdo licencues duhet të përcaktojë palët e përfshira, të drejtat dhe detyrat e tyre, kriteret dhe proceset e nevojshme në përputhje me këtë rregullore për hyrjen në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra (shih Paragrafin 5.03).

C.2 Procesi

C.2.1 Licencuesi duhet të finalizojë formulimin e rregullores nacionale të licencimit të klubeve dhe ta dërgojë atë në UEFA në një nga gjuhët zyrtare të UEFA-së, për shqyrtim brenda afatit të komunikuar nga kjo e fundit.

C.2.2 Licencuesi është përgjegjës për të siguruar dhe duhet t'i demonstrojë UEFA-së se të gjitha dispozitat e zbatueshme të kësaj rregulloreje janë integruar në rregulloren e tij nacionale të licencimit të klubeve. Përgjashtimet mund të bëhen sipas Nenit 13 të kësaj rregulloreje.

C.2.3 Licencuesi është i lirë të rrisë ose të prezantojë kritere minimale shtesë në rregulloren e tij nacionale të licencimit të klubeve me qëllim të hyrjes në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra.

C.2.4 Kur futet nga licencuesi në rregulloren e tij nacionale të licencimit të klubeve, çdo kriter minimal i rritur ose shtesë zbatohet *mutatis mutandis* për hyrjen në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për Femra.

C.2.5 Licencuesi duhet t'i konfirmojë UEFA-së se të gjitha dispozitat e përfshira në rregulloren nacionale për licencim të klubeve janë në përputhje me legjislacionin shtetëror në fuqi.

C.2.6 Rregullorja nacionale e licencimit të klubeve duhet të miratohet nga organet kompetente nacionale dhe t'iu komunikohet aplikuesve për licencë para fillimit të procesit të licencimit. Ajo nuk mund të ndryshohet gjatë procesit të licencimit, përveç nëse miratohet siç duhet nga UEFA.

C.2.7 UEFA shqyrton versionin përfundimtar të rregullores nacionale të licencimit të klubeve dhe i konfirmon me shkrim licencuesit se:

- a. dispozitat e aplikueshme të kësaj rregulloreje për qëllim të hyrjes në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për Femra janë të integruara në rregulloren nacionale për licencimin e klubeve.
- b. licenca e lëshuar nga organet kompetente nacionale sipas rregullores nacionale të licencimit të klubeve bazohet në kriteret minimale të përcaktuara në pjesën II të kësaj rregulloreje.

C.2.8 Licencuesi inkurajohet të aplikojë një sistem licencimi të klubeve për të rregulluar pjesëmarrjen në garat e tij vendore. Për këtë qëllim, licencuesi është i lirë të rrisë, zvogëlojë ose të fus kritere minimale shtesë në rregulloren e tij nacionale të licencimit të klubeve me qëllim të dhënies së lejes për të marrë pjesë në garat e tij vendore.

Aneksi D Aplikimi i jashtëzakonshëm i sistemit të licencimit të klubeve

D.1 Parimet

- D.1.1** UEFA përcakton afatet e nevojshme dhe kriteret minimale për aplikimin e jashtëzakonshëm të sistemit të licencimit të klubeve siç specifikohet në Paragrafin 17.01 dhe ua komunikon ato licencuesve më së voni deri më 31 gusht të vitit para sezonit të licencave.
- D.1.2** Licencuesit duhet të njoftojnë UEFA-në për çdo kërkesë të jashtëzakonshme aplikimi me shkrim, duke treguar emrin e klubit në fjalë, brenda afatit të komunikuar nga UEFA.
- D.1.3** Licencuesi është përgjegjës për paraqitjen e kriterëve të klubi në fjalë për vlerësim të kërkesës për aplikim të jashtëzakonshëm. Ata gjithashtu duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme me klubin në fjalë për t'u përgatitur për procedurën e jashtëzakonshme të aplikimit.
- D.1.4** Klubi në fjalë duhet t'i sigurojë licencuesit provat e nevojshme me dokumente që do të vlerësojë klubin kundrejt standardeve minimale fikse dhe t'ia përcjellë UEFA-së dokumentacionin e mëposhtëm në një nga gjuhët zyrtare të UEFA-së brenda afatit të komunikuar nga kjo e fundit:
- Kërkesë me shkrim për leje speciale për të hyrë në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra;
 - Rekomandim nga licencuesi bazuar në vlerësimin e tij (duke përfshirë datat dhe emrat e personave që kanë vlerësuar klubin);
 - Të gjitha provat e dokumentuara të ofruara nga klubi dhe licencuesi siç kërkohet nga UEFA;
 - Dokumente të tjera të kërkuara nga UEFA gjatë procedurës së jashtëzakonshme të aplikimit.
- D.1.5** UEFA e mbështet vendimin e vet në dokumentacionin e marrë dhe jep leje të posaçme për të hyrë në Ligën e Kampionëve të UEFA-së për femra nëse plotësohen të gjitha kriteret dhe nëse klubi përfundimisht kualifikohet me meritë. Vendimi i komunikohet licencuesit, i cili duhet t'ia përcjellë atë klubit në fjalë.
- D.1.6** Nëse një klub i tillë eliminohet me meritë gjatë procedurës së jashtëzakonshme të aplikimit, licencuesi në fjalë duhet të njoftojë menjëherë UEFA-në dhe procedura ndërpritet menjëherë, pa vendim të mëtejshëm. Një procedurë e tillë e përfundimit nuk mund të rifillojë në një fazë të mëvonshme.

D.1.7 Kundër vendimeve përfundimtare të marra nga UEFA mund të bëhet ankesë me shkrim pranë Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (GJAS) në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të UEFA-së.

Aneksi E Kërkesat e zbulimit të informacioneve për pasqyrat financiare

E.1 Parimet

- E.1.1** Pavarësisht kërkesave të praktikës nacionale të kontabilitetit, Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ose Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Subjektet e Vogla dhe të Mesme, kriteret financiare të kësaj rregulloreje kërkojnë që aplikuesit për licenca/të licencuarit të paraqesin një nivel specifik minimal të informacionit financiar tek licencuesi, siç përcaktohet në Nenin 56.
- E.1.2** Çdo komponent i pasqyrave financiare duhet të identifikohet qartë. Informacioni i mëposhtëm duhet të shfaqet në mënyrë të dukshme dhe të përsëritet aty ku është e nevojshme brenda pasqyrave financiare, për një kuptim të duhur të informacionit të paraqitur:
- a. Emri (dhe forma ligjore), vendbanimi dhe adresa e biznesit të subjektit/subjekteve raportuese dhe çdo ndryshim në atë informacion që nga data e mëparshme e referencës së kontabilitetit vjetor;
 - b. Nëse informacioni financiar mbulon aplikuesin për licencë/të licencuarin individual, një grup subjektësh ose ndonjë kombinim tjetër subjektësh, dhe një përshkrim të strukturës dhe përbërjes së çdo grupi apo kombinimi të tillë;
 - c. Data e referencës së kontabilitetit vjetor dhe periudha e mbuluar nga informacioni financiar (si për informacionin aktual ashtu edhe për atë krahasues); dhe
 - d. Monedha e prezantimit.
- E.1.3** Nëse pasqyrat financiare vjetore nuk janë në përputhje me kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të përcaktuara në Aneksin E, atëherë aplikuesi për licencë duhet t'i paraqesë licencuesit edhe:
- a. informacion plotësues për të përmbushur kërkesat e zbulimit të informacionit të përcaktuara në Aneksin E;
 - b. raport vlerësimi të ofruar nga i njëjti auditor që nënshkruan pasqyrat financiare vjetore me anë të procedurave të dakorduara, të përshkruara nga licencuesi në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare të ri-deklaruara.

E.2 Bilanci

- E.2.1** Kërkesat minimale për dhënie informacionesh shpjeguese për artikujt e bilancit janë paraqitur më poshtë.

Asetet

- i. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj
- ii. Asete të tjera rrjedhëse
- iii. Asete të prekshme dhe jo të prekshme
- iv. Llogaritë e arkëtueshme
- v. Asete të tjera afatgjata
- vi. Totali i aseteve (shuma e pikave nga i) deri në v)

Detyrimet

- vii. Kredi bankare dhe kredi të tjera
- viii. Llogari të tjera të prapambetura
- ix. Detyrime të tjera rrjedhëse
- x. Detyrime të tjera jo-rrjedhëse
- xi. Totali i detyrimeve (shuma e pikave vii) deri në x)

Kapitali

- xii. Kapitali total

E.3 Llogaria e fitimit dhe humbjes

- E.3.1 Kërkesat minimale për dhënien e informacioneve shpjeguese për llogaritjen e fitimit dhe humbjes janë paraqitur më poshtë.

Të hyrat

- i. Faturat e hyrjes
- ii. Sponsorizimi dhe reklamimi
- iii. Të drejtat e transmetimit
- iv. Aktivitete tregtare
- v. Solidariteti dhe të çmimeve në të holla të UEFA-së
- vi. Subvencione, donacione, kontribute dhe grante të tjera
- vii. Të ardhura të tjera operative
- viii. Të hyrat totale (shuma e pikave nga i) deri në vii)

Shpenzimet

- ix. Shpenzimet e përfitimit të punonjësve
- x. Shpenzime të tjera operative
- xi. Shpenzimet totale të operimit (duke përjashtuar regjistrimet e lojtarëve) (shuma e pikave ix) deri në x)
- xii. Rezultati neto nga transferimet e lojtarëve
- xiii. Të ardhura neto jo-operative /(shpenzime) - të tjera
- xiv. Të hyrat/(shpenzimet) tatimore

- xv. Dividentët e paguar/interesat e pakicës
- xvi. Shpenzimet totale (shuma e pikave nga xi) deri në xv)

E.4 Pasqyra e fluksit të parasë

- E.4.1 Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të raportojë rrjedhën e parasë për periudhën financiare, të klasifikuar ndaras si më poshtë:

Fluksi i parasë nga aktivitetet operative

Aktivitetet operative janë aktivitetet kryesore që krijojnë të hyra të subjektit raportues dhe aktivite të tjera që nuk janë aktivite investuese ose financuese. Prandaj, ato përgjithësisht rezultojnë nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera që hyjnë në përcaktimin e rezultatit neto. Kërkesat minimale të zbulimit të informacionit janë deklaruar më poshtë:

- i. Hyrje/dalje monetare neto nga aktivitetet operative.

Flukset e parasë nga aktivitetet investuese

Aktivitetet investuese janë blerja dhe asgjësimi i asetëve afatgjata (përfshirë regjistrimet e lojtarëve) dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e parave të gatshme. Kërkesat minimale të zbulimit të informacionit janë deklaruar më poshtë:

- i. Hyrje/daljet monetare neto nga aktivitetet investuese

Flukset monetare nga aktivitetet financuese

Aktivitetet financiare janë aktivite që rezultojnë në ndryshime në madhësinë dhe përbërjen e kapitalit aksionar të kapitalit të kontribuar dhe huamarrjeve të subjektit raportues. Kërkesat minimale të zbulimit janë deklaruar më poshtë:

- i. Hyrje/daljet monetare neto nga aktivitetet financiare

Flukse të tjera monetare

Flukset monetare nga interesi dhe dividendët e pranuar dhe të paguar duhet të shpalosen ndaras. Secila duhet të shpaloset në mënyrë të vazhdueshme nga periudha në periudhë si veprimtari operative, investuese ose financuese.

Flukset monetare që rrjedhin nga tatimet mbi të ardhurat duhet të shpalosen veçmas dhe të klasifikohen si flukse monetare nga aktivite operative, përveç rasteve kur ato mund të identifikohen në mënyrë të duhur dhe specifike si aktivite financimi ose investimi.

- E.4.2 Përbërësit e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare duhet të shpalosen dhe duhet të bëhet një barazim i shumave në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, me artikujt ekuivalent të raportuar në bilanc.

Aneksi F Nocioni i detyrimeve të vonuara

F.1 Parimet

F.1.1 Detyrimet konsiderohen si të vonuara nëse nuk paguhen sipas kushteve kontraktuale ose ligjore.

F.1.2 Detyrimet nuk konsiderohen si të vonuara, sipas kuptimit të kësaj rregulloreje, nëse aplikuesi për licencë/i licencuari (d.m.th. debitori) është në gjendje të vërtetojë brenda afatit në fuqi, pra 31 mars lidhur me Nenin 57, Nenin 58, Nenin 59 dhe Nenin 60. që:

- a. shuma përkatëse është shlyer, pra është paguar plotësisht ose është kompensuar kundrejt detyrimeve të kreditorit ndaj debitorit; ose
- b. afati për pagesën e shumës përkatëse është shtyrë (referuar si "shuma të shtyra" në këtë rregullore), d.m.th. është lidhur një marrëveshje me shkrim me kreditorin për të zgjatur afatin e pagesës (një kreditor që nuk kërkon pagesën e një shume nuk përbën zgjatje të afatit); ose
- c. shuma përkatëse i nënshtrohet një pretendimi ligjor ose procedurave të hapura (të referuara si "shumat e kontestuara" në këtë rregullore), që do të thotë:
 - i. debitori ka ngritur një kërkesë ligjore e cila është konsideruar e pranueshme nga autoriteti kompetent sipas ligjit shtetëror ose ka hapur procedura me autoritetet nacionale ose ndërkombëtare të futbollit ose gjykatën përkatëse të arbitrazhit sportiv duke kundërshtuar përgjegjësinë në lidhje me detyrimin e pagesës së vonuar, duke ditur se nëse organet vendimmarrëse (licencuesi ose OUKFK) konsiderojnë se një kërkesë e tillë është ngritur ose një procedurë e tillë është hapur me qëllimin e vetëm për të shmangur afatet e zbatueshme të përcaktuara në këtë rregullore (d.m.th. për të blerë kohë), shuma do të konsiderohet ende si një detyrim i vonuar; ose
 - ii. debitori i ka kundërshtuar autoritetit kompetent sipas ligjit shtetëror, autoriteteve nacionale ose ndërkombëtare të futbollit ose gjykatës përkatëse të arbitrazhit, një pretendim që është ngritur ose procedura që janë hapur kundër tij nga një kreditor në lidhje me detyrimet e prapambetura dhe është në gjendje t'iu demonstrojë organeve vendimmarrëse përkatëse (licencuesit ose OUKFK-së) se ka përcaktuar arsyet për kontestimin e pretendimit ose procedurave që janë hapur, duke ditur se nëse organet vendimmarrëse (licencuesi ose OUKFK) marrin parasysh arsyet për kontestimin e kërkesës ose procedurave si haptazi të pabazuara, shuma do të konsiderohet ende si pagesë e vonuar; ose
- d. shlyerja e shumës përkatëse është në pritje (të referuara si "shuma në pritje" në këtë rregullore), që do të thotë:

- i. debitori ka kërkuar nga autoriteti kompetent, me shkrim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, që të shtyjë afatin për pagesën e detyrimeve për autoritetet sociale/tatimore (siç përcaktohet në Nenin 59) dhe autoriteti kompetent ka konfirmuar me shkrim se kjo kërkesë është konsideruar e pranueshme dhe ende në pritje deri më 31 mars (në lidhje me nenin 59); ose
- ii. debitori është në gjendje të demonstrojë suksesshëm tek organet përkatëse vendimmarrëse (licencuesi ose OUKFK) se ka marrë të gjitha masat e arsyeshme për të identifikuar dhe paguar kreditorin(ët) në lidhje me kompensimin e trajnimit dhe kontributet e solidaritetit (siç përcaktohet në *Rregulloren e FIFA-së për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve*).

Aneksit G Procedurat e licencuesit për vlerësim

G.1. Parimet

- G.1.1** Licencuesi përcakton procedurat e vlerësimit, duke siguruar trajtim të barabartë të të gjitha klubeve që aplikojnë për licencë. Ai shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga klubet, vlerëson nëse ai është i përshtatshëm dhe përcakton suksesshëm nëse secili kriter është përmbushur dhe çfarë informacioni të mëtejshëm, nëse ka, nevojiten që të jepet një licencë.
- G.1.2** Proceset e vlerësimit për të kontrolluar përputhshmërinë me dispozitat e përcaktuara në Nenin 11 përfshijnë hapa të veçantë vlerësimi që duhet të ndiqen nga licencuesi, siç përcaktohet më poshtë.

G.2 Vlerësimi i raportit të auditorit mbi pasqyrat financiare

- G.2.1** Në lidhje me pasqyrat financiare vjetore, licencuesi duhet të kryejë procedurat e mëposhtme të vlerësimit minimal:
- Të vlerësojë nëse perimetri i raportimit është i përshtatshëm për qëllime të licencimit të klubeve;
 - Të vlerësojë informacionin e paraqitur për të formuar një bazë për vendimin e licencimit;
 - Të lexojë dhe të merr parasysh pasqyrat financiare vjetore dhe raportin e auditorit për to;
 - Të adresojë pasojat e çdo modifikimi në raportin e auditorit (krahasuar me formën normale të raportit të pakualifikuar) dhe/ose mangësitë krahasuar me kërkesat minimale të dhënies së informacioneve shpjeguese dhe kontabël sipas Aneksit G.2.2 më poshtë.
- G.2.2** Pas vlerësimit të perimetrit të raportimit dhe leximit të raportit të auditorit mbi pasqyrat financiare vjetore, licencuesi duhet t'i vlerësojë këto sipas pikave të mëposhtme:
- Nëse perimetri i raportimit nuk plotëson kërkesat e Nenit 55, licenca duhet të refuzohet;
 - Nëse raporti i auditorit ka një opinion të pakualifikuar, pa asnjë modifikim, kjo ofron bazë të mirë për dhënien e licencës;
 - Nëse raporti i auditorit ka një mohim të opinionit ose një opinion të kundërt, licenca duhet të refuzohet, përveç rasteve kur jepet një opinion pasues auditimi pa mohim të opinionit ose opinion negativ (në lidhje me një grup tjetër financiar, pasqyrat për të

- njëjtin vit financiar që plotësojnë kërkesat minimale) dhe licencuesi është i kënaqur me opinionin pasues të auditimit;
- d. Nëse raporti i auditorit ka, në lidhje me vazhdimësinë, një theksim të çështjes, një çështje kyçe të auditimit ose një opinion të kualifikuar 'përveç', licenca duhet të refuzohet, përveç nëse:
 - i. jepet një opinion pasues auditimi pa vazhdimësi, një theksim të çështjes, një çështje kyçe ose kualifikim auditimi, në lidhje me të njëjtin vit financiar; ose
 - ii. Të jenë dhënë prova shtesë të dokumentuara që demonstrojnë aftësinë e aplikuesit për licencë për të vazhduar deri të paktën në fund të sezonit të licencës, dhe vlerësuar nga licencuesi.
 - e. Nëse raporti i auditorit ka, në lidhje me një çështje të ndryshme nga vazhdimësia, një theksim të çështjes, një çështje kyçe të auditimit ose një opinion të kualifikuar 'përveç për', atëherë licencuesi duhet të marrë parasysh implikimet e modifikimit për qëllime të licencimit të klubeve. Licenca mund të refuzohet nëse nuk sigurohen prova të dokumentuara shtesë dhe nuk vlerësohen suksesshëm nga licencuesi. Dëshmia shtesë që mund të kërkohet nga licencuesi do të varet nga arsyeja e modifikimit të raportit të auditimit;
 - f. Nëse raporti i auditorit i referohet ndonjë situatë të përcaktuar në Nenin 54, licenca duhet të refuzohet.

G.2.3 Nëse Aplikuesi për licencë ofron informacion shtesë dhe/ose pasqyra financiare të ri-deklaruara, licencuesi duhet të vlerësojë gjithashtu raportin e auditorit mbi procedurat e dakorduara në lidhje me informacionin plotësues dhe/ose me pasqyrat financiare të ri-deklaruara. Licenca mund të refuzohet nëse raporti i auditorit vlerësohet negativisht nga licencuesi dhe/ose ka referenca për gabime dhe/ose përjashtime të gjetura.

G.3 Vlerësimi i dokumentacionit të licencimit për detyrime të prapambetura

G.3.1 Në lidhje me kriteret “pa detyrime të prapambetura/të vonuara” ndaj klubeve të futbollit, punonjësve dhe autoriteteve sociale/tatimore, licencuesi mund të vendosë:

- a. të vlerësojë vetë informacionin e dorëzuar nga aplikuesi për licencë, me ç’rast ai duhet të kryejë vlerësimin siç përcaktohet në Aneksin G.3.2; ose
- b. që auditorët e pavarur të kryejnë procedurat e vlerësimit në përputhje me ISRS 4400, me ç’rast licencuesi duhet të vlerësojë informacionin e dorëzuar nga aplikuesi për licencë (në veçanti tabelat e detyrimeve dhe dokumentet përkatëse mbështetëse) dhe të rishikojnë raportin e auditorit. Licencuesi mund të kryejë çdo vlerësim shtesë që ai mendon se është i nevojshëm, duke përfshirë zgjerimin e mostrës ose duke kërkuar prova të dokumentuara shtesë nga aplikuesi për licencë.

G.3.2 Pavarësisht nëse vlerësimi kryhet nga licencuesi ose nga një auditor i pavarur në lidhje me kriteret e “pa detyrime të prapambetura” ndaj klubeve të futbollit, punonjësve dhe autoriteteve sociale/tatimore, duhet të kryhen procedurat minimale të mëposhtme dhe të përshkruhen në raportin e licencuesit ose të auditorit:

- a. Për të marrë tabelat e pagesave të 31 marsit, të dorëzuara nga aplikuesi për licencë në lidhje me detyrimet që duhet të paguhet deri më 28 shkurt (p.sh. tabela e transferimeve, tabela e punonjësve, tabela sociale/tatimore dhe dokumentet përkatëse mbështetëse);
- b. Për të kryer hapat e nevojshëm (përfshirë përcaktimin e madhësisë së mostrës) për të vlerësuar plotësinë dhe saktësinë e bilanceve të raportuara dhe për të nxjerrë një përfundim në lidhje me secilën nga procedurat e kryera;
- c. Për të kontrolluar plotësinë e çdo bilanci të vonuar, të raportuar nga aplikuesi për licencë më 28 shkurt;
- d. Për të kontrolluar shlyerjen e çdo pagese të vonuar ndërmjet 28 shkurtit dhe 31 marsit; dhe
- e. Për të identifikuar çdo bilanc të vonuar më 31 mars.

G.3.3 Në lidhje me kriterin "pa detyrime të vonuara" në lidhje me UEFA-në dhe licencuesin, licencuesi duhet të kryejë, të paktën, procedurat e mëposhtme të vlerësimit:

- a. Për të rishikuar çdo informacion të marrë nga UEFA në lidhje me shumatat e papaguara të borxhit nga klubet e lidhura me licencuesin dhe për të kontrolluar shlyerjen e çdo teprice të vonuar midis 28 shkurtit dhe 31 marsit; dhe
- b. Për të kryer çdo vlerësim shtesë dhe për të kërkuar çdo provë shtesë të dokumentuar nga aplikuesi për licencë që ai e konsideron të nevojshme.

G.4 Vlerësimi i përfaqësimit me shkrim përpara vendimit për licencim

G.4.1 Në lidhje me përfaqësimin me shkrim, licencuesi duhet të lexojë dhe të marrë parasysh ndikimin e çdo ndryshimi të rëndësishëm që ka ndodhur në lidhje me kriteret e licencimit të klubit.

G.4.2. Licencuesi duhet gjithashtu të lexojë dhe të marrë në konsideratë informacionin në lidhje me çdo ngjarje ose gjendje me rëndësi të madhe ekonomike, në kombinim me pasqyrat financiare, informacionin financiar të ardhshëm dhe çdo dëshmi të dokumentuar shtesë të ofruar nga aplikuesi për licencë. Licencuesi mund të vendosë që ky vlerësim të kryhet nga një auditor.

G.4.3 Licencuesi duhet të vlerësojë aftësinë e klubit për të vazhduar si vijimësi deri të paktën në fund të sezonit të licencës. Licenca duhet të refuzohet nëse, bazuar në informacionin financiar që licencuesi ka vlerësuar, sipas gjykimit të licencuesit, aplikuesi për licencë mund të mos jetë në gjendje të vazhdojë si vijimësi deri në fund të sezonit të licencës.

G.4.4 Nëse Aplikuesi për licencë (ose anëtari i regjistruar i cili ka një marrëdhënie kontraktuale me aplikuesin për licencë në kuptim të Nenit 14) ose ndonjë kompani amë e aplikuesit për licencë të përfshirë në perimetrin e raportimit kërkon/kërkonte mbrojtje ose ka marrë mbrojtje nga kreditorët e saj në përputhje me ligjet ose rregulloret brenda 12 muajve para sezonit të licencës ose është duke marrë mbrojtje në momentin e vlerësimit, atëherë licenca duhet të refuzohet. Për të shmangur dyshimin, licenca duhet të refuzohet edhe nëse subjekti në fjalë nuk është duke marrë më mbrojtje nga kreditorët e tij në momentin e marrjes së vendimit të licencimit.